

SKËNDER HUSHI



**EMNAT ATLANTIDEO-
PELLAZGO-ILIRË
NËPËR BOTË**

**(dhe kuptimi i tyre me anën e gjuhës shqipe të sotme,
që gabimisht janë quejtë arap, turk, grek, sllav etj).**

SHTATOR 2014

SKËNDER HUSHI

**Emnat atlantideo-pellazgo-ilirë
nëpër botë**

dhe kuptimi i tyre me anën e gjuhës shqipe të sotme.
(Që gabimisht janë quejtë arap, turk, grek, sllav etj)

-----O-----

Vazhdim i librit: “EMNAT ILIRË NËPËR BOTË”
Përfshin emna të përdorun në shumë vende të botës.

SHTATOR 2014

**Librin ua kushtoj mërgimtarëve shqiptarë, kudo nëpër botë,
që, krahas halleve të përditëshme për mbajtjen e familjes
jashtë vendit, ndihmojnë edhe të afërmit në Shqipni.**

**Me sukseset në vend të huej, ndihmojnë atdheun e tyre, që
t'i ndriçohet faqja e t'i rritet lavdia.**

Nxorri materialet nga kompjuteri dhe bani
sistemimin e librit-

Erin Hushi

Ndreqi gabimet e piksimeve-

Ramazan Hushi

Vizatimi i faqes së fundit dhuruar nga-

Bashkim Kllloboçishta.

Shtëpia botuese - **EMAL**

ISBN-978-9928-04-266-8

**E drejta e botimit dhe e ribotimit të këtij libri i takon vetëm
autorit Skënder Hushi**

PËRMAJTJA

1 - Parathania e autorit		faqe	5.
2 - Disa fjalë njirokëshe të shqipes së sotme.		faqe	23.
3 - Emnat që fillojnë me germën A		faqe	36.
4 - Emnat që fillojnë me germën B		faqe	105.
5 - Emnat që fillojnë me germën C		faqe	144.
6 - Emnat që fillojnë me germën Ç		faqe	173.
7 - Emnat që fillojnë me germën D		faqe	175.
8 - Emnat që fillojnë me germën Dh		faqe	202.
9 - Emnat që fillojnë me germën E		faqe	204.
10 - Emnat që fillojnë me germën Ë		faqe	240.
11 - Emnat që fillojnë me germën F		faqe	240.
12 - Emnat që fillojnë me germën G		faqe	262.
13- Emnat që fillojnë me germën Gj		faqe	291.
14- Emnat që fillojnë me germën H		faqe	296.
15- Emnat që fillojnë me germën I		faqe	321.
16- Emnat që fillojnë me germën J		faqe	338.
17- Emnat që fillojnë me germën K		faqe	369.
18- Emnat që fillojnë me germën L		faqe	402.
19- Emnat që fillojnë me germën Ll		faqe	427.
20- Emnat që fillojnë me germën M		faqe	427.
21- Emnat që fillojnë me germën N		faqe	472.
22- Emnat që fillojnë me germën Nj		faqe	494.
23- Emnat që fillojnë me germën O		faqe	494.
24- Emnat që fillojnë me germën P		faqe	506.
25- Emnat që fillojnë me germën Q		faqe	534.
26- Emnat që fillojnë me germën R		faqe	536.
27- Emnat që fillojnë me germën Rr		faqe	558.
28- Emnat që fillojnë me germën S		faqe	558.
29- Emnat që fillojnë me germën Sh		faqe	594.
30- Emnat që fillojnë me germën T		faqe	602.
30- Emnat që fillojnë me germë Th		faqe	630.
31- Emnat që fillojnë me germën U		faqe	633.
32- Emnat që fillojnë me germën V		faqe	641.
33- Emnat që fillojnë me germën W		faqe	660.
34- Emnat që fillojnë me germën X		faqe	672.
35-Emnat që fillojnë me germën Xh		faqe	673.
36- Emnat që fillojnë me germën Y		faqe	675.
37- Emnat që fillojnë me germën Z		faqe	684.
37- Emnat që fillojnë me germën Zh		faqe	691.
39- Përmbledhje e emnave nëpër botë		faqe	693.
40- Grafikët e gjuhës atlantideo-ariano-albane		faqe	695.

Parathanie

Në vazhdim të diskutimeve, komenteve dhe këshillave nga miq të ndryshëm, në drejtim të librit tem “Emnat ilirë nëpër botë”, po vazhdoj të shtjelloj mendimet e mia në këte libër të dytë.

Libri im “Emnat Ilirë” më dha mundësi të njifem me shumë studiues dhe gjuhëtarë, ku shumica më përgëzuen dhe më uruan për atë libër. *Nji përqindje e vogël, kishin rezerva, ose ishin kundër. Këto “të rezervuemit” kryesisht ishin e janë rrogatë nga shteti e shumë herë edhe nga organizma të huaja dhe “u jap të drejtë”, sepse ata janë mësue, që vetëm për zbërthimin e një fjalie, të marrin shpërblime dhe udhëtime jashtë shtetit e jo ma të merren me zbërthimin e shumicës së emnave, siç po sforcohem të merrem unë, duke përdorë studimet e shumta, që kam ba, intuitën, eksperiencën teme e të prindënve, gjyshënve e të afërmve të mij, që me këtë rast i falenderoj nga zemra.*

Disa nga këta studiues, të mësuem me të tjera teori, kur lavdërohen e paguhen nga të “huaj”, në dam të vendit e të zanatit të tyne, shpesh janë mohuesit e çdo gjaje shqiptare e pellazgo-iliro-shqiptare.

Kam rastin këtu t’i përmbahem diskutimit të zotit Niko Stillo në një diskutim të akademikëve tanë jasht vendit, ku, nga katër diskutues, akademikë shqiptarë, që folën për gjuhën shqipe dhe influencën e gjuhës së fqinjëve ke shqipja, ai vërejt në ato diskutime, se 120 përqind të fjalëve të shqipes, ata diskutues “shqiptarë” i quanin fjalë të huazueme nga fqinjët (4 diskutues fushnin nga 30 përqind secili huazime nga gjuhët: greke, italiane, sllave dhe turke, kur matematika nuk pranon ma shumë se 100 %).

Zoti Niko Stilo ua argumentoi me fakte atyne, se ato fjalë, që ata kishin paraqitë në atë mbledhje si: greke, latine, sllave apo turke ishin fjalë, që kishin ekzistue në këto troje, para se ato kombësi të krijoheshin në gadishullin ilirik. Për të qesh e për të qa!

Disa studiues nga shumë vende, e sidomos në Shqipni e në Itali, ku po banoj prej kohësh, shumë fjalë të vjetra etruske, latine dhe europiane, me shumë kuptim në gjuhën shqipe dhe që i shpjegon shumë mirë gjuha shqipe e sotme, mundohen t’i krahasojnë me fjalë nga persishtja, sanskritishtja, gjuha indiane e të tjera gjuhë shumë të vjetra e të largëta, për të cilat ka pak të dhana. Unë i thashë e u them atyne se kjo gja asht si historia e një njeriu, që ngjitet në majë të malit, në fund të botës, me shumë rreziqe, për të kap atje një lule të dobët e të pazh villueme nga mungesa e ushqimit, kur e gjithë fusha dhe oborri i shtëpisë së tij asht plot me po atë lloj luleje, por ma të shëndetshme e ma të plota se ajo lule e largët, që ai e mori me aq vështirësi. **Unë u them: -ja ku e kam ujkun, ja ku e keni, jua kam pru përpara, që ta shifni e ta prekni, ju më thoni: prit se do e gjejmë ne mbas gjurmëve.** Mendoj se me anën e emnave të sotëm, (të cilët i mendoj si “etalon”), mund të shofim se si ka qenë mënyra e shkrimit dhe e përdorimit të germave në të

kaluemen e lashtë, të shifën ndryshimet e të hartohen metoda krahasuese për lehtësimin e kuptimit të shkrimeve të vjetra. **Kemi një thesar të çmuem para syve e duhet ta përdorim, sepse të gjithë emnat e njerëzve, kafshëve, bimëve, emnat e vendeve etj kanë pasë fol e flasin shqip.**

Falenderoj gjyshnit e stërgjyshnit, që na i kanë lanë trashëgim me dashuni e saktësi deri në ditët tona, qysh nga thellësia e historisë së njerëzimit.

Nji mikut tem, mësues i gjuhës shqipe, i them me shaka se “ju mësuesit e gjuhës jeni magazinjera të fjalëve”. Ata e dijnë me saktësi se në çfarë “magazine, rreshti, rafti, kati e në çfarë dosje” (emërtimet dhe format gramatikore), ndodhet kjo ose ajo fjalë dhe dijnë shumë pak për historinë e gjuhëve të lashta shqipe dhe botnore. Mendoj se ka ardhë koha të krijohet dega: “Historia e gjuhëve të vjetra nëpër botë”, ku persona të specializuem të flasin me siguri se nga e ka origjinën kjo apo ajo fjalë e jo t’i bien shkurt: Me origjinë arape, turke, greke, italiane etj.

Disa më thonë se po i thjeshtoj e po i lehtësoj shumë shpjegimet me anën e këtyne librave. U jam përgjigj e u pergjigjem atyne se edhe natyra ndjek rrugën ma të shkurtën për bashkëveprime. Elektriciteti, magnetizmi, rrezatimet, graviteti etj, veprojnë në vijë të drejtë dhe shfrytëzojnë rrugën ma të shkurtën për të bashkëveprue me njana tjetrën. Çdo njisi rritjeje të hapsinës e dobson cilësinë, duke e zvogluë në fuqi të dytë. Edhe komunikimet midis qenieve të gjalla, në fillim kanë qenë të thjeshta, të drejtëpërdrejta e duke u zhvillue qenia e gjallë, u shtuen e u përmirësuen mënyrat e komunikimit, por bazamenti i vjetër, i thjeshtë, i kollajshëm, hamendësues (intuitiv), telepatik, i shejtë ngelet dhe mbi atë bazament vazhdon zhvillimi. Kështu e mendoj edhe gjuhën. **Gjuha shqipe ka meritën se ruen akoma të gjalla format e fillimit, nga komunikimi me shenjat e fytyrës me *isharete*, në fjalë e shprehje me një tingull, me një zanore, me një bashkëtingëllore e me një rrokje, që përbajnë bazamentin e gjithë gjuhëve të botës.**

Gjuhën tonë e shof shumë të shëndetëshme, të padamtueme e të pa ndryshueme nga koha dhe me bindje e them, që duhet të merret si etalon (et-t’à-lon), si gjuhë e zanafillës, për krahasimin e fjalëve të gjuhëve të ndryshme nëpër botë.

Gjithashtu, ndërtimi dhe domethania e emnave, ngulmoj të them, se duhet të përdoren si “etalon=et-të-a-lonë”, sepse kanë mijëra vite që trashëgohen me saktësi nga njani brez në tjetrin, gojarisht dhe me anën e shkrimeve, pa asnjë ndryshim dhe janë një minierë thesaresh gjuhësore, që i shof si fjali të shkurtua me kuptim të plotë me gjuhën shqipe, që flasim sot.

Ndërkohë kam lexue edhe shumë studime dhe libra të ndryshëm. Libra të ndryshëm për paranormalen, fizikën kuantike dhe teori të ndryshme, të gjitha, që më ndifmojnë të shtoj njohunitë për këte lloj studimi që po baj. Librat i z. Petro Zhei, “Shqipja dhe sanskritishtja” dhe “Libri i aforizmave”, në fillim

m'u dukën shumë të vështirë për t'u kuptue, por tashti, me njohunitë që kam marrë, i vlerësoj ma shumë dhe e falenderoj nga zemra z. Petro për ato libra.

Qysh në lashtësi, në studimet e trashëgueme nga Thoti dhe sot në fizikën kuantike shpjegohet bindshëm se çdo gja në GJITHËSI nuk asht gja tjetër veçse **valë energjie**, ku format: -i gaztë, -i langshëm, -i gurtë, janë forma të ndryshme të **përqëndrimit të energjisë**. Materialet e ngurta janë një kujtesë e energjisë së kyçun ke ata gurë apo minerale, të cilat po të dihet të zbërthehen, na mësojnë për historinë e universit. Me anën e gjuhës shqipe shpjegohet shumë mirë edhe përmbajtja, domethania e emnit që mban guri. Fjala **“gur”** në disa gjuhë asht: **Gar, gir, gor, gur, gjur, gyr, gjyr** dhe **pietra** në gjuhët italice. Këto emërtime më japin direkt e plotësisht me anën e gjuhës shqipe, përmbajtjen e gurit, që e kuptoj si: Gji ur=rracë, gjindje, varietet hyjnor, që bahet urë për t'u lidh me universin. Gar, Gor=gji ar=gji or; Gir, Gyr= gji ir, gji yr=rracë, varietet yjnor, hyjnor. Edhe fjala italiane “pietra”, plotësisht e shpjegueme me gjuhën shqipe, më thotë të njajtën gja: Pi-et-ra= pin nga pleqsitë e etënve të lashtë, ra (nga qielli, nga Gjithësia).

Menhir, men-hir quhen disa gurë të mëdhej, që në lashtësi i përdornin si vende të shenjtë e si vende për t'u falun, por në shqip kuptohen menjëherë si: mend me hirësi, me mendime hyjnore.

Në lashtësi edhe tashti, disa fëm praktikojnë faljen pranë këtyne gurëve të shenjtë, ose mureve me gurë “qiklopikë”, gja të cilën e shpjegon edhe Thoti ke libri: “Plakat e Zmeraldit” dhe asht një mënyrë faljeje shumë e vjetër (mbi 12 000 vjeçare).

Nji mik, studiues nga Roma, Antonio Trinchese, nji ditë më çoi mesazh në Facebook e më përgëzoi për librin “Emnat ilir”-“Antichi nomi” në italisht, sepse ke emni Artur-Arthur, në nji studim të tij për mbretin Artur të Anglisë, i kishte dhanë kuptim balladave të vjetra të popullit anglez, që mbretin e tyne Artur e quenin pikërisht: urë prej ari, ose: ai na thur me ar, (Arthur). Ky autor e quante mretin Artur=Arthur, me originë ilire nga Dalmacia. Iu përgjigja, se derisa ka ngel atje, në balladat e tyne popullore ky kuptim i lashtë, atëhere edhe popullsia e lashtë angleze ka pas fol gjuhën shqipe. Ene ai ishte i nji mendjeje me mue, (“ene” mendoj se asht ma preçise nga “edhe”).

Ene emnat kanë pas nji qëllim të caktuem: Nuk ishin e nuk janë thjesht nji fjalë emërtuese, siç i marrin popujt, që nuk e njofin gjuhën shqipe, por janë nji fjali preçise me nji domethanie preçise (prë-ç'is). (Mendoj se fjala “Sak, saktë”, që përdor shqipja, nuk asht e plotë, sepse duhet: Isak=is-ak=isht-hak=isht i-e drejtë, pa gabime, i-e arsyeshëm-e etj). **Fëmijës i vihej nji emën, që ta mbante me krenari për gjithë jetën, që të ishte udhërrëfyes për atë, që të kishte kuptim e jo thjesht nji emën sa për ta pas, psh: Nail=Na à il=Na asht il-yll. Rabihana=Ra bia e Hanës; Zyra=Zë, zani i hyut ra (nga qielli). Hasan, Asan=Asht Hanë. Adil=Asht Diell etj. Emni nuk kishte randësi se me çfarë germe mbaronte në fund, me zanore “a, e” për femna dhe me “o, i, u”, ose me bashkëtingullore për**

meshkujt. I njajti emën mund të përdorej për të dyja gjinitë, sepse nuk ishte thjesht një emën, por një fjali e shkurtën, pre-çis'e dhe shprehëse.

Në vendet anglishtfolëse emnat janë gati të njëjlojtë, pa zanore-folje në fund te emnave, si për goca ashtu edhe për çuna, gja që më shton bindjen se emnat janë ndërtime me kuptim të njëjtë për të dyja gjinitë e që vërteton sa thashë ma sipër.

Zanoret e fundit ishin pjesë të foljes shqipe “me qenë, me ekzistue”: a, aq, as, asht; è, eç, esht, është; iç, isht, iq; oç, osh, osht; uç, us, usht; yç, ysh, ysht.

Në shqip kemi fjalën (foljen) kap dhe s'kap. Në italisht asht ba s'kapa (scapa=s-çapa)=s'kap-à, sepse kur ikën me të shpejtë (s'kapa, s'çap) nuk të kap njeri, s'kapesh.

Rrezja, në italisht thuhet raggi=ra-ggi=ra-gji=ra nga qielli apo nga Dielli, gjini i ngroftë i Gjithësisë. Me të vërtetë, rrezja ngrof dhe asht ushqimi, që na vjen nga Gjithësia. Ato rreze janë shkak për të ngrof tokën e për zhvillimin e ushqimeve, të gjasë së gjallë e të njerëzisë, të gjindjes. Në gjuhë të tjera bahet “ragi=ray, që na jep: ra-gi=ra y, ra hyu, ra ylli” e më ban lidhjen e fjalës shqipe “gji” me gjinin e ngroftët të yllësive, të hyjnive të zbritun nga yjet.

Në italisht kemi: razza=raz-za=rranz zaj në gegnisht. Me të vërtetë emërtimi i rracës, asht pikërisht ajo gja: një varietet, një rracë, një rrazë, rranzë, rranxë e re e filizave të rinj, që krijohet e shtohet.

Gjatë këtyne studimeve, kam pa që gjuha italiane, meqë ka disa mijëra vjet që shkruhet pa ndërprerje, asht ma preçize në rruajtjen e fjalëve të shkrueltuna, shumica me përsëritje dyshe të bashkëtingulloreve e ma pak të zanoreve, që për të mos i përsëritun, i vejnë apostrof perpara.

Në fillim, kur shkova në Itali dhe nuk e dija gjuhën italiane, këto lloj shkrimesh më dukeshin të çuditshme e të pashpjegueshme. Kur i pyesja italianët se përse ishin ashtu, me dy germa, më thoshin se ashtu kishin ngel nga lashtësia dhe ata nuk mund t'i ndryshonin. I falenderoj për këte kokëfortësi në rruajtjen e fjalëve dhe emnave të vjetër, sepse pikërisht aty ku janë dy germa, tregohet se janë dy fjalë të ndryshme, që na krijojnë një fjali, që me anën e gjuhës shqipe marrin kuptim, psh: Etta=Et-t'à=Et-të asht, ku “et” kuptohet me matuninë, pjekuninë, pleqësinë. Etta asht njësi matëse e pjekunisë së çdo gjaje. Ettalon=Et të à lon, asht pikërisht njësi matëse e saktë, njësi preçisioni (pre-çis-joni). Emni i Egjyptit=Egitto=E gjith-t'ò=E gjith të osht, e rracës tonë të asht.

Në shqip, bashkëtingëllorja “Xh”, shpesh herë ia ka humb kuptimin fjalëve, por në italisht, ku germa “G” lexohet “Xh” e shpjegon ma mirë kuptimin e shumë fjalëve me këte bashkëtingullore. Nëse e shkrueltjm në shqip: Hanxhiu, arkaxhiu, bakraxhiu etj nuk kuptojmë gja, ndërsa po të shkruhen italisht me “g”e të lexohen si italianët, ku germa “g, gj” lexohen “xh”, do të kemi: hangjiu, arka-gjiu, bakra-gjiu, ku “giu, gjiu” asht pikërisht si në shqipen e sotme, gjiu i familjes. Siç e kam thanë në librin tjetër, në kohën e Kostandinit të

Madh në shekullin e IV të kësaj ere, për mos të pas telashe me regjistrimin e zantaçijve (zan-at=zejn pleqsi, nzajn dituni), vuni ligjin, që zanatet të trashëgohen në bazë gjinie, familjeje. Në malësinë e veriut përdoren edhe në ditët e sotme emnat: Gjini, Gjina, që në italisht lexohen Xhin, Xhina.

Nëse shofim kuptimin e fjalës "gjyle", të predhës së topit na del kuptimi preçis simbas emnit= gji, gjy-yl-è=rracë, gjindje ylli është. Gji-yl-le=racë, gjindje yllorë leu. Me të vërtete, një gjyle topi, kur fluturon në qiell duket si një yll që asht duke fluturue në qiell.

Nëse shkruhen me "G" në vend të "xh", shumë fjalëve shqipe, që i përdorim si fjalë emërtuese të pakuptimita, i del kuptimi i vërtetë si psh: Oxhak=ogjak, ò gjak. Në të vërtetë rreth oxhakut (o gjakut), mblihet e gjithë familja, që janë të një gjaku.

Gjon lexohet Xhon. Ndërsa emni Gian-o, në shqip shqiptohet Xhian-o, Xhihan-o. Emni Gian-o përdoret ma shumë në Itali se sa në Shqipni, ku përdoret si mbiemër, ose në formën: Gano, Gani. Fjala "xhihan" asht e shpeshtë si mbiemër në Shqipni. Simas fjalorit turk, asht gradë në ushtrinë turke. Nëse e shkruajmë Gjihan, gji Han, na del kuptimi i kësaj fjale. Udhëheqësit e Azisë së Vogël, në lashtësi kanë qenë quejtë me gradën Han, që e lidh me kultin dhe adhurimin e Anës, Hanës, që asht kult i trashëguem nga lashtësia, shumë ma përpara se fetë e sotme të kishin lindun nëpër botë. Pra "xhihan", gjihan mer kuptimin: racë hanore, racë udhëheqësisht, gjindje udhëheqëse.

Edhe emërtimi: Hoxha, oxha bahet: -o gja, e më len ta kuptoj në dy mënyra: osht i gjakut tonë, por asht gja, asht diçka, asht me dituni dhe me këte shpjegim, kuptoj që fjala "hoxhë, oxha, ogjia" asht fjalë shqipe. Mbaresa "ue" në dialektin geg mendoj se do ishte ma e saktë vetëm me "u".

Akademikët që merren me rregullat e drejtëshkrimit, duhet t'i korregjojnë këto gabime e të shtojnë në gjuhën shqipe elemente të dialektit geg, të çamërishtes, të arvanitishtes, arnautishtes e të arbërishtes, germat me theks si dhe fjalët hundore të hequna padrejtësisht. Gjithashtu duhen riejtë të pashjeshtueme fjalë apo emna, edhe nëse kanë germa dyshe mrena, sepse ato germa dyshe na krijojnë një fjali të vogël e shprehëse ke ato fjalë e emna të vjetër. Në këte mënyrë, fëmijët tanë do e kenë ma kollaj të mësojnë çdo gjuhë të botës, që ka marrë për bazë këto kombinime dhe që janë pasardhëse të Atlantideo-pellazgëve. Thjeshtimi i tepërt i gjuhës do ia ulë vlerat asaj e do na kthejë ke gjuha e kumurieve, që vetëm me "ku ku, ku" po merren vesh, por do humbim lidhjet me origjinën, me lashtësinë e kësaj gjuhe yllorë, për të cilën jemi krenarë.

Thjeshtimin e gjuhës dhe të dialekteve shpesh e kam quejtë sikur të thjeshtosh një simfoni madhështore, e cila përfundon vetëm me një notë, që sado e bukur të jetë kur përsëritet pa fund, të mërzit kthehet në zhurmë pa kuptim.

Në internet e në shtyp disa shkrimtarë të rij po mburren sepse po e pasunojnë gjuhën shqipe duke krijuar fjalë të reja e duke futur kultura të hueja në gjuhën shqipe. U jam përgjigj e u përgjigjem atyne, se asht një gabim i madh ai veprim i tyne. Mendoni se sa qindra shkrimtarë e se sa dhjetra vepra shkruajn ata. Sikur të gjithë të shtojnë fjalë “të reja” pa kuptimin e lashtë, nga gjuha jonë yllore, nuk do ngelet asgjë e çdo vit duhet të mësojmë një gjuhë tjetër të re. Gjuhën duhet ta rrejtmë si dritën e syve siç ka qenë në lashtësi e nëse ka fjalë të hueja, të hiqen e të zavendesohen me fjalët tona të njivlefshme ene në dialekte.

Deri në këto ditë, dikush nëpër katundet tona i thotë grues së tij me ledhe ”Oj xhike”, dikush e përdor me përbuzje: ”osht xhikë ajo”, por po të vazhdoj ta analizoj këte fjalë, më del një fjalë e bukur. Në një libër me kangë të vjetra çame, thuhej: “xhike, xhiko” dhe i thuhej një gruaje të nderueme e fisnike. Nëse këte fjalë e shkruem me “G, Gj” do kemi: gjika, gjike, gjiko e del një fjalë shprehëse dhe i jap të drejtë shpjegimit të çamëve. Gjika, gjika don të thotë se asht nanë e një gjindjeje, e një rrace të fortë, ose thjesht ngaqë ishin të shnetëshme, trup mëdhaja e me gjokse, gjinjë të mëdhej. Fjala “Gjina, gjini, gjindje, gjika”, ka qenë përdor shumë në të kaluemen, pikërisht në kuptimin e popullit të një rrace të fortë. Sot ma pak. Edhe nga historianë të ndryshëm të lashtësisë, na vijnë të dhana se në popullsinë pellazgo-ilire, edhe para kristianizmit dominonin emnat: Gjergj, Gjini, Gjoni, Gjorgj e për femna: Gjina-e, Margjina, Mara, Maria, Marta, Margjela etj.

Shumë emërtime e fjalë, gjatë kalimit të shekujve, në popuj të ndryshëm kanë marrë kuptime të ndryshme. Psh në shqip kemi “kapuk, kap-uk”, që don të thotë: i fortë saqë kap, mbërthen edhe ukun, ujkun. Populli e përdor për djemt e rij që bredhin nga një femën ke tjetra. Kopil-e, në të kaluemen ka pas kuptimin: kap il, dmth, i-e bukur si yll-a. Kjo pasqyrohet edhe në kangët e vjetra ku i këndojnë bukurisë së “kopiles”, vajzës së virgjën. Sot përdoret për fëmijët e jashtligjëshëm. Çapon=Çap Hon, kap Honën. Emërtim që u vihet popullsisë ortodokse shqiptare dhe shqiptaro-vlla-he, por, siç shifet, emërtimi i tyne asht shumë i bukur në shqip.

Xhamia, nëse e shkruem duke zavendësu “XH” me “G, gj” do kemi: gjamia=gji-a, mi-à; gjini, gjindje, e gjindjes asht, mi, mbi të tjerët asht e del kuptimi funksionues i këtij objekti që asht i naltësuem e në shërbim të gjindjes, të popullatës. Xhemat, xhumat=Giumat=Gjiu-ma-at=Gjindja mban atin (per ta përcjell në varreza). Minare=min ar è, në arabisht asht: manar=man-ar, në italisht: Minaretto=min-ar-et-t’ò, që me fjalë ma të gjata e kuptoj se minarja, manarja, minaretto (=min ar et t’e ò) asht një vend, që ban të mbijë arin dhe pleqsitë nga aty. Nga studimet e fundit të fizikës kuantike, kullat e nalta të vendeve të shenjta, bajnë me të vërtetë rrolin e antenave për të lidh mendimet dhe ndjenjat e njerëzisë me njana tjetrën dhe mendimet e njerëzisë me universin, ose anasjelltas. Disa i quejnë edhe bateri që furnizojnë tokën me energji pozitive.

Ene emërtimi i kishës, në disa dialekte të Shqipnisë, në Kalabri e në vende të tjera shqipfolëse, quhet “qishë, qisha” dhe mer kuptim nga shqipja. Në të folmet dialektore, kemi zavendësimin e fjalëve: ki, ky = qi, qy, që përdoren edhe sot në dialekte të ndryshme. Kisha=qisha=ki-ish-à=qi-ish-à, ki, ky, qi, qy **ish**, ku “ish” ka kuptimin e ekzistencës, e shejtit (kujtoni njerëzit e shejtë me emnat **Is-a, Is-is** ej), pra kisha=ki **ish** à, qisha=qi, qy, ky **ish** à; ky asht vendi i të shejtëve, vendi i Zotit. Në formën (në variante=bariante=ba-ar-ri-an-t`è) italisht bahet: Kies-a, ki-es=ki-es, (lexohet “kiez”) asht po e njajta gja si në shqip: ki-es=ki-**ish** ku es=is=**asht**=**esistenza**=**jeta**=**Zoti**.

Emnin e Kuranit e has në disa forma dhe i jap shpjegim në shqip. Shofim se Kuran shkruhet edhe koran, kuran, quran, qyran të njëvlefshëm me fjalët=ky ur An; ky or, ar An; Qy yr, hyri Ane, ky hyri Hane, e në shqip na japin kuptimin, që ai libër ka shërbye si urë për lidhjen e shpirtit të njerëzve me simbolin e shejtë e yjnor të Hanës, që ka qenë rrespektue dhe rrespektohet edhe sot. Ishte ene i vlefshëm si ari, por edhe i shejtë si hyritë e Hanës. Nuk asht e rastësishme rruajtja me respekt deri në ditët e sotme të simbolit të Hanës nga myslimanët, italianët e në shumë popuj të tjerë. Studiuesit e feve të vjetra duhet ta kenë parasysh edhe këte lidhje me gjuhën shqipe të atij libri të shejtë, ashtu si edhe (unxhili)= ungjili=un-gji-ili= një ngrohtësi (gji) yllore, ose nëse baj: Un=An=Hana do kemi: Hana e gjinisë yllore. Edhe emni i Musa=Mesi-a, Misa, Misaele, M`is-a-el-è=m`us-à=m`is-à=M`es-i-à, nëse zavendësojm: **as=es=is=us=os=jeta=esistenca=Zoti**, atëhere kuptohen menjherë në shqip me fjalët: Më asht jeta, me asht ekzistenca, më asht Zoti, dhe nga ky kuptim arrij në përfundim se këto emna nuk janë emna të vërtetë, por të vendosun nga shkrujtësit e librave të shejtë, që e dinin gjuhë <https://www.facebook.com/skender.hushi>ën atlantideo-albane e për t`i krahasue me Zotin ata personazhe të feve të tyne, u vinin ata emna. Studiues të ndryshem po e vërtetojnë këte gja.

Në librat e tjerë kam thanë se shumë fë mendojnë se do ketë rikthim profeti në Tokë, por nëse kthehet, çfarë gjuhe do flasë ky profet me njerëzit?

Nga studimet e bame, më del që ai ka pas fol shqip e s`duhet t`ia humbim meritat gjuhës së popullit dhe vendit tonë, që disa, çdo gja duen ta quejnë të huej, jo shqiptare, latine, italiane, turke, arape etj. Duhet të mburremi me originën tonë atlantideo-ariano-pellazgo-ilire-shqiptare, që gati asnjë popull tjetër nuk e ka. Fqinjët, edhe pse nuk e kanë, po mundohen ta përvetësojnë origjinën tonë si të tynen. Edhe emnat e ashtuquejtun fetarë, nuk janë të feve të ndryshme, por janë puro atlantideo-ariano-shqip, sepse fetë janë kriju shumë ma vonë se populli shqiptar, që simas legjendave ka ekzistue në tokë para së të krijohet Hana.

Fetë e ndryshme kanë shfrytëzue e përdor emnat, që gjetën ke venalijetë ariano-shqiptarë.

Gjatë studimit të emnave në fjalorët e emnave turk e arap, studiuesit atje, për ato emna që nuk ia dinin kuptimin, por që shpjegohen shumë mirë me shqipen e sotme, aty thonë: Emna të vjetër turk apo arap, ndërsa në shqiptarët, që i japim shpjegim e i kemi emnat tonë, vazhdojmë t'i quejm të huej. Gjithashtu duke studiue domethanien e emnave në turqisht dhe në arabisht, shof se ata i kanë vu një domethanie shumicës së emnave që përdoren atje, por ato domethanie nuk përputhen me përkthimin simbas fjalorit dhe gjuhës së folun atje. Kurse në shqip marrin kuptim të drejtë për drejtë, të plotë e të bukur me gjuhën e folun sot nga shqiptarët e shqipfolësit kudo nëpër botë.

Nga studiuesit italianë, dihet që germa “g” asht shtue në shekullin e II para erës së re në shkrimet italiane, por interesante asht që shqipja e shpjegon domethanien edhe simas formës së kësaj germe. “G” të madhe dhe “g” e vogël, që nuk janë gja tjetër veçse imitim i gjoksit, gjiut të njerëzve dhe asht quejt pikërisht si në shqip: gi, gji (lexohet në italisht xhi). Kjo futje i qëllon kohës kur Iliria u thye nga Roma dhe u banë një shtet, një perandori dhe atje fillon të ndihet edhe influenca ilire ndaj gadishullin italik e në krejt perandorine romake, ku, siç dihet, shumica e perandorëve filluen të ishin me origjinë ilire. Me anën e kësaj forme janë kriju edhe shumë fjalë që shpjegohen me shqipen si: giro (xhiro), girare= me ec rrumbullak simas formës së gjiut, gjithësia, gje, gje-a. Gji-a=gjaja=ga-ia=Gaia; Gjeo=toka e rrumbullakët si gju, etj.

Në shkrimet italiane, nëse në fjalë të ndryshme shof kokfortësi në rruajtjen e bashkëtingulloreve dyshe, me zanoret janë tregue ma pak kokfortë ose përdorin apostrofin për të mos e përdor një zanore dy herë. Këte veprim e kuptoj të drejtë dhe e shpjegoj me faktin, se në gjuhën e folun atlantideo-shqipe e në dialektet e popujve latinë, shpesh herë zanoret hiqeshin ose zavendësoheshin me forma të ndryshme nga “A” deri ke zanorja “Y”simas dialekteve (psh., kemi: à, asht, è, esht, ë, është, dhe deri ke: ù, usht, y, ysht. Mama, moma, muma. La, le, li, lo, lu, lind, lynd etj). Zanoret “i, j, y”, shpesh herë bien. Kjo më ka detyrue, që shpesh herë aty ku mungojnë, të mundohem t'i shtoj, që emnat të marrin ma kuptim me gjuhën shqipe. Në popujt e vjetër latinë (ose: letinë; la-at-inë=le-et-inë=ka le i dituni ynë) dhe në zona të ndryshme të Europës ene në Shqipni, shof zavendësimin e zanores “U” në vendt të zanoreve të tjera psh: Ana=Una=Hana. Asht, osht=usht, uç. Mama, moma, muma. Mondo-mundo=bota. Got-gut. Gor-gur. Ke emnat e vjetër na ka ngel në format: As, Aç, Taç=të aç, të asht. Uç e Tuç=t’uç=të uç=të usht. Mendoj se folja “asht”, ka pas ekzistue ene në format yç, ys, ysh, ysht (gjysh = gji-ysh, kelysh=ke el ysh. Gji’us’tin=Gji’yst’in etj).

Në studimin e emnave të gjuhëve të ndryshme, shof emna, që janë të ndërtuem ene me dy zanore të ngjituna, që kur ndahen më japin një fjali të shkurtën e me kuptim në gjuhën shqipe.

Në të kaluemen gati nuk ka qenë përdor zanorja “ë”, e cila në fillimet e disa shkrimeve e shof të zavendësue me apostrof. Tashti po hiqet apostrofi e po zavendësohet me “ë”.

Në internet e në librari ka fjalorë të gjuhëve të ndryshme dhe fjalorë emnash me shpjegimet e tyre në gjuhën përkatëse, të cilët i shfletoj shpesh. Emnat dhe matertialet për këte libër i kam marrë nga interneti, nga numeratorët telefonikë, nga listat zgjedhore, nga jeta e përditëshme, nga personazhe librash të ndryshëm, që kam lexue dhe për emnat e vjetër, futem ke wikipedia, në internet për të marrë ndonji sqarim. Shof që në shumicën e rasteve, shpjegimet e emnave, nuk përputhen me fjalorin e shpjegimit të fjalëve të gjuhëve përkatëse, gja që më shton sigurinë se emnat janë me originë atlantideo-ariano-albane-shqipe gati në të gjithë botën.

E kam thanë edhe ke kopertina e këtij libri: Gjatë punimin me librin “Emnat ilir”, më dukej vetja si punonjës miniere, që gërmon e nxjerr thesare nga thellësia e shekujve. I takon specialistave t’i shohisin e t’i vlersojnë.

Gjithashtu shof se gjatë analizës së emnave edhe germa “G” ndryshohet në “J” dhe në “Y”, psh: Giorgio=Jorgo. Giozef, Giozefia= Jozef=Jozefi=Josif=Jusuf=Yozef . Giacobe bahet Jakob, Jakop e në Jakub, Jakup. Në shqip “G” bahet “xh, j”, Psh Giani –*Xhiani, Xhani*; Gianina=*Xhanina, Janina* etj. Këte e shpjegoj në transformimin dhe përshtatjen, që popuj të ndryshëm, simbas dialektit dhe gjuhës së vendit të tyre kanë ba ke ato emna, që vetëm kur i shof të shkrueltun në italisht, mund t’i zbërthej ma kollaj me anën e shqipes. Prandaj zbërthimin e kuptimit duhet ta kërkojme në burim, në formën e parë të shkrueltun e të ruejtun nga italishtja dhe me shpjegimin në shqip. Edhe emnat e fëmijeve duhet të vihen me shkronjat e originës, siç janë ruejt në italisht e jo me këto të ndryshuemet, po deshëm të vazhdojmë të ruejmë gjuhën tonë dhe kuptimin e bukur që mbartin ata emna.

Disa fjalë e emna të vjetër kanë qenë shkruelt me germën “X” dhe shumë studiues këte germë e lexojnë “Ç, K, KS” ose “H”. Shof se me anën e shqipes dhe italishtes, emërtimet e vjetra marrin kuptim me këte bashkëtingullore. Folja shumë e vjeter “KA” në italisht shkruhet “HA” e në shqip kuptohet “KA” dhe kanë ruejtë mënyrën e leximit “H dhe K” të kësaj germe (“X”) qysh nga lashtësia. Nëse e shofin germën “X” e nëse ia drejtojmë krahun e majt bahet K dhe nëse ia drejtojm dy ansoret, bahet H. Kjo na tregon edhe fazat e ndryshimit dhe përshtatjes së kësaj germe simbas dialekteve, me kalimin e shekujve. Në italisht “oxa, hoxha” lexohet “oksa”. Max=Maks. Për këte domethanie do ndalem prap gjatë shpjegimit të emnave në këte libër.

Po diskutohej në internet nji shkrim i vjetër, që asht shkruelt: XAIRE. Un dhash mendimin, që po të shkruhet: “K” bahet Ka-ir è ose me “H” bahet: Ha ir è dhe jep të njajtën përgjigje nga italishtja: Ka hir è, ka bukuri hyjnore është, ose: Hair=à ir, asht ir dhe na shpjegon fjalët e vjetra shqipe: haire, hajër, por edhe fjala hairet (ahiret=ah-ir-et), që mbahet si fjalë arape, del shqipe. Nëse

“ha, ho” e italishtes, në shqip bahet bahet KA=Me pas. Në shqip kemi: Ha, ho=asht, osht=à, ò hundore. Gjithashtu, në dialekte të shqipes “xa”=me nshanë, por edhe: “xa”=ç’à=ç’àsht. Ax=aç. Xa=za. Ex=Eç, etj.

Në gjuhë të ndryshme “X” lexohet “KS”. Vërej se në gjuhën greke të sotme haset shpesh dhe mendoj se po të zavendësohet “ks” e sotme e greqishtes si ma sipër fjalët e emnat do marrin kuptim të plotë me shqipen e sotme.

Nji ditë po mendoja që t’i përgjigjesha pyetjes teme: Çfarë origjine ka fjala “nam”, që në vende të ndryshme të botës i thuhet emnit, ose themi: asht me “nam”, asht me emën, asht me famë, asht me “namus, nam-us”, asht me ndershmëni.

Besoj se shpjegimin e kësaj fjale e gjejmë në shqipen. Në dialektin çam thuhet: am lule, am dorën, etj, me kuptimin: ma jep, me dhanë. Në dialektin e Kavajës ne themi: name lapsin, ose neme bukën, ma nep bukën, ta nap dorën etj. Shofim pra, që fjala-rranje “AM” na krijon fjalë të tjera: n’am= me dhanë. Nga ana tjetër populli, kur don të shpjegojë linden e një fëmije thotë: Zoti më dha një fëmijë. O Zot më nem, më n’am, më n’ep një fëmijë të hairit! Në analizën e kuptimit të emnave, emnat: Le-ka, Le-na, Lin-da, Lan-da, etj kuptohen, që ata fëmijë janë le, janë lind, janë lanë, janë dhanë nga Zoti për tu ba me emën, me nam, të famshëm, të hairit. Nëse lidhim fjalën çame ”am” =me dhanë, me fjalën e dialektit të Shqipnisë së Mesme, nem, nam=ma jep, nepe, jepe=me dhanë, atëhere edhe fjala “nam, nam-e-i” mer kuptim në shqip (i-e dhanë nga Zoti për tu ba dikush, për tu ba me emën). Emni i nji personi asht i dhanë, i nepet atij, i “n’am’et”, dhe asht nji titull nderi që do e mbajë për të gjithë jetën. Namus, namuz=n’am-us, (us=is=esistenza) ke ne ka kuptimin e nderit, që asht e barasvlevshme me vetë qenien, me vetë ekzistencën e personit që e mban, gja që lidhet me arsyetimin e masipërm.

Shofim që edhe emërtimi shumë i lashtë i Zotit të Egjyptit, Amon mer kuptim me çamërishten (çamçe=çam’ç’e) tonë: Am-jon, i dhonmi jonë, i zbrituni jonë, i shtrejtj jonë, i shejti jonë, ose Am Hon=mama Hona, ku simboli i Hanës, Honës rrespektohet edhe sot.

Në italisht do=dho. Dona=do-na-à=dho-na-à=dhonëse fëmijësh na asht, gja që e kam shpjegue edhe ke libri im i parë “Emnat ilirë nëpër botë”. Në shqip dhe në shumë gjuhë të botës nana quhet: ana, anë, ama, mama, moma, muma, nana, nena, nëna, nona, nuna.

Nëse do fillojmë t’ua shpjegojmë fëmijëve nëpër shkolla këto mënyra që sqarohen në këte libër, mendoj se ata fëmijë do e kenë ma të lehtë t’i kuptojnë të gjitha gjuhët e botës njikohësisht. Në mësimin e gjuhës shqipe do të rikthehen studiuesit nëpër botë për t’u dhanë shpjegim me anën e shqipes shumë enigmave gjuhësore nëpër botë, që kanë ngelun të pashpjegueme nga lashtësia.

Në praktikën e studiuësve nëpër botë ndiqet mënyra e referimit.

Dikur diku në Afrikë asht zbulue një kafkë njerëzore disa mijëra vjeçare. Edhe sot gati të gjithë studiuesit i referohen vetëm asaj kafke dhe thonë se i gjithë qytetnimi botnor e ka originën nga ajo specie, të cilës i përket ajo kafkë dhe historia njerëzore fillon në atë vend ku asht gjet ajo kafkë. Mendoj se gjinia njerëzore ka qenë e kudondodhun nëpër botë. Sot teoritë e reja të transmetimit të mendimeve dhe ideve, po na mësojnë se sado e prapambetun dhe e pazhvillueme të jetë një gjini qeniesh të gjalla, nëse një individ mëson një gja apo një veprim të ri për mbijetesë e për rritjen e mirëqenies së llojit, ky veprim u transmetohet të gjithë pjestarëve të tjerë të asaj gjinije, me anën e shikimit, vrojtimit direkt, ose me anën transmetimit të mendimeve, kudo që ata ndodhen. Vrojtme të sjelljes së majmunëve makako kanë provue vitet e fundit këtu, që thash këtu.

Dikur, diku në një shpellë janë zbulu disa piktura me njerëz parahistorikë, nga ku edhe sot studiusit thonë se origjina e qytetnimit botnor fillon nga aty.

Dikur diku janë zbulu disa armë bronzit dhe ai vend quhet vendlindja e qytetnimit të bronzit.

Diku tjetër janë zbulu armë hekuri dhe atij vendi vazhdojnë edhe sot t'i referohen studiuesit si vendlindja e periudhës së hekurit. Edhe pse me kalimin e viteve po bahen zbulime të reja, që i hedhin poshtë të parat, prap se prap shumë studiues u përmbahen thanieve të para.

Kjo mënyrë pune duhet të ndryshohet. Janë ba zbulime, se para 4000 vitesh në Babiloni kishte vendbanime, që kultivonin grunin e të gjithë studiuesit thonë se kultivuesit e grunit janë të shpërndamë nëpër botë nga Babilonia, India dhe Azia e Vogël. Nuk e përjashtoj lëvizjen e popujve, që ndodh edhe sot, por vendasi ka qenë dhe mbetet kryesori. Sot po bahen gërmime në zonën e Devollit në Shqipëri dhe janë konstatu qytetnime, që qysh para 8 000-10 000 vjetësh kanë pasë përdor grunin, bagëtinë dhe kuajt dhe asnjë nuk e merr për bazë.

Disa studiues dhe shkrimtarë kanë thanë që qytetnimi europian asht me origjinë greke. E gjithë bota përsërit thaniet e tyre, edhe pse çdo ditë po dalin fakte të reja, që nuk ka qenë qytetnim grek, por pellazgo-ilir (ilir=elir, elim=elin=elen). Bota nuk don të ndryshojë mendim e të korregjojë librat e maparshëm. Asnjani nuk i merr parasysh këto, sepse duhet të korregjohen të gjithë librat.

Mendoj se ashtu si edhe librat e shkencës dhe të makinerive, edhe librat e historisë e të gjuhës duhet të gjykohen simbas shkallës së zhvillimit të shkencës në atë kohë që janë kriju ato libra.

Nuk mund të mendohet, që makinat moderne të punojnë me po ato pjesë që kanë pas makinat e vjetra, në fillim të krijimit të tyre. E reja e vendos në muze të vjetrën. Po kështu edhe me zbulimet. Zbulimet e reja duhet të korregjohen, përmirësojnë e pasunojnë ato të ma përparshmet.

Çdo ditë po dalin fakte të reja se zhvillimi i botës 12 000 vjet ma parë, e ma në thellësi të kohës, kur ekzistonte Atlantida, ka qenë shumë ma i zhvilluem se sot, por edhe këte studiuësit e mbulojnë dhe s'duen ta marrin parasysht.

Në shumë shtete të botës, e nisin historinë pikërisht atëhere kur nis të krijohet ai komb (pushtues). Historitë e maparshme i fshijnë e mundohen t'i fallsifikojnë dhe ti ndryshojnë në të mirë të tyne.

E kam thanë edhe ke libri i parë, që kjo gja asht si me e nis historinë e kontinentit të Amerikës vetëm nga koha kur asht pushtu nga europianet, në shekullin e XV, duke ia fshi historinë mijëra vjeçare të saj, gja që deri diku ia kanë arrit qëllimit edhe atje, sepse pak dihet nga historia e popullsisë vendase të Amerikës së lashtë, që mu më dalin të afërt me ne dhe me Atlantidën, që asht pika, që na bashkon me ato popuj të lashtë atje dhe provon vjetërsinë e kombit tonë në këte dhe.

Të njajtën gja po bajnë shtetet e reja të ngritura mbi tabanin e popullsisë atlantideo-pellazgo-ilire-albane, si Turqia, Greqia, Serbia, Rumania, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria etj shtete të Europës, që po bajn ç'asht e mundun me prish, me mëçef e me ndryshu historinë e lavdishme të botës e tonën (e një pjesë asht ene e atyne), duke shkatërru, mëçef e ndryshu zbulimet e lashta në vendet e tyne.

E njejta gja ndiqet edhe me gjuhët. Çdo gja krahasohet me disa pllaka gjoli të pjekme, të zbulueme në Babiloni, disa gurë varri nëpër botë etj dhe ngulmohen e merren parasysht si pika referimi, ene pse nuk njëfjet mirë gramatika e atyne shkrimeve, që megjithatë nga shumë studiuës asht dhanë mendimi se vetëm me anën e gjuhës shqipe mund të zbërthehet kuptimi i atyne shkrimeve. Shpesh shumë shkrime në gurë të vjetër, janë plot me gabime e të shkruajtuna nga gurgdhendës analfabetë, që e kishin mësu shkrimin "me të vjedhun". Mendoj se në gjuhësi, ashtu si edhe në shkencat e tjera, duhet të përdoren metoda matematikore të sakta, që të nxirren përfundime të sakta e të pagabueme.

Zhdukja e gjuhës, traditës dhe e historisë së lavdishme pellazgo-ilire-shqiptare do të jetë një dam i madh për të gjithë Europën e Botën, e cila i ka rranjëtet e zanafillës këtu, ke **ne** dhe **NE** jemi ata, që e kemi ruejtë ma së miri këte gjuhë yllore deri më sot.

Me këte rast po jap mendimin tem për një formë matematikore:

Le të shofim ndërtimin e fjalëve në gjuhë të ndryshme. Ka fjalë një rrokshe, të përbame edhe vetëm nga një zanore, psh: "a"=asht; a=aaa=shprehje habie, dhimbje apo kënaqësie. Po ashtu edhe zanoret "e", "ë", "i", "o", "u", "y". Ka fjalë të ndërtueme edhe vetëm me një bashkëtingullore psh: "b,b,b"=belbëzimi i fëmijës. "c, c, c k"=nuk, jo; "S"=nuk, jo; "S"=sss=shët, pusho. "F"=ffff për të dhanë parafytyrimin e fluturimit apo të ajrit, që lëviz e deri ke germa "Z", zzz që imiton zhurmën etj. Ata që studiojnë frekuencat e tingujve, besoj se do na japin një pasqyrë të frekuencave të të gjithë tingujve në gerrat e përdoruna nëpër botë, dhe bashkimet e tyne në fjalë-formime,

krijojnë melodi të ndryshme, për secilin dialekt e gjuhë. Të gjithë këto për bamës me një tingull, me një zanore, me një bashkëtingëllore apo me një rrokje (à, asht, am, ec, ça, ik, la, le, ul, hy, y, yll etj), që kanë kuptim në secilën gjuhë, le të quhen njësi bazë gjuhësore. Ashtu si germat e alfabetit, edhe këto njësi gjuhsore, duke qenë njësitë ma të vogla, (ndamjet ma të vogla), janë me një numër të kufizuem. Germat e alfabetit në shqip janë 36. Në gjuhë të tjera janë ma pak apo ma shumë, por kombinimet e fjalëve që krijojn këto 36 germa janë me mijëra. Po ashtu edhe numri fjalëve shprehëse me një germë ose me një rrokshe duhet të jetë pak ma i madh, por edhe këto me numër të kufizuem dhe bashkimi i këtyne fjalëve-shprehje një germëshe apo me një rrokje na krijojnë me mijra krijime të tjera.

Këto njësi bazë unë do i quej bazamentin e çdo gjuhe dhe çdo gjuhë do ta mas në vartësi të këtij bazamenti. Çdo gjuhe të botës i vej një numër apo një germë të alfabetit. Meqë gjuha shqipe quhet edhe albanese e quej gjuhën “A”, italiane “I”, latine “L” etj për shtete të ndryshëm.

Çdo gjuhë e ndërtoj me 100 apo 1000 njësi pastërtie. Përshembull: gjuha bazë e shqipes ka 1000 “A”, e latinishtes 1000”L”, e italishtes 1000”I” etj. Në këto 1000 njësi të ndryshme shof se sa njësi “A” ka në gjuhë të tjera dhe sa njësi me germa të tjera i janë shtu gjuhës shqipe-albane. Kështuqë psh do kemi për gjuhën shqipe: 1000 “A” plus 2”L” plus 4”I” plus ...etj=1000”A”,2”L”,4”I”, etj. Po ashtu veprohet edhe me gjuhët e tjera. Nëse psh fjalët latine të rifutuna në shqip janë “A,L”quhen të për bashkëta. Me kaq sa dij, elementin bazë “A” të gjuhës albano-shqipe e shof të shpërndamë në të gjitha gjuhët e botës, ndërsa elemente të gjuhëve të tjera në shqip janë shumë ma të pakta, gja që tregon pastërtinë e gjuhës sonë dhe influencën e saj në gjuhët e tjera. Në gjuhë të ndryshme përdorin fjalë të për bame nga këto njësi bazë si fjalë emërtuese e jo si një fjalë e vogël e precise, siç i shpjegon gjuha shqipe me këto njësi bazë të saj.

Një model matematik të këtij lloi e kam përdor me sukses në llogaritjen e rezultateve të llotarive të futbollit në vitet 90 dhe në çdo 5-6 ndeshje fitoja një llotari të vogël dhe në çdo 20-24, fitoja një të madhe, duke luejt vetem 2 mundesitë e le jume (2 kollona-që lejonin). Ma vonë ma vështirësuen punën, sepse merrnin nga 4-6 skuadra të hueja nga vende të ndryshme të botës, kështuqë duhej të bajsha shumë llogaritje, për të gjitha skuadrat e botës, për të cilat s’më dilte ma koha. (Në ate kohë llogaritjet i bajsha me dorë. Tashti kanë dalë kompjutrat).

Ndofta ky shembull mund të mos jetë preçis, ose mund të mos jetë bindës, por shkencëtarët duhet të gjejnë një formë matematikore, sepse format krahasuese apo të referimit unë i quej të pa baza, ose të për kohshme, që me kalimin e viteve duhet gjithmonë të rishikohen e të korregjohen. ***Nëse ban gabim me dashje apo pa dashje studiuesi i parë, të gjithë studiuesit e mavonshëm, që i referohen atij studiuesi nuk bajn gja tjetër veçse***

shumfishojnë atë gabim të parë, duke rrejt veten, por edhe studentët e tyne dhe gjithë popujt e botës.

Edhe në librat e shkences, çdo zbulim i ri, krijon libra e teori të reja, të cilat hedhin poshtë e i nxjerrin të pavlefshme librat dhe teoritë e ma parshme si psh: teoria e relativitetit spostoi atë të Njutonit. Tashti, teoria e fizikës kuantike po sposton atë të relativitetit.

Makinat me avull zavendësuen karrocat. Makinat me karburant, zavendësuen ato me avull. Tashti po dalin makina eletrike që po zavndesojnë këto me karburant etj etj shembuj.

Kam ndjek diskutimet e disa studiuesve shqiptarë për gjuhën në internet dhe shof se ka disa diskutues, që i referehen teorive të gjuhëve “centum e satem” si dhe gjuhëve IE për të nxjerrë përfundime për gjuhën shqipe. Për mendimin tem, ato teori janë të pa sakta dhe çdo autor, që i ka kriju ato, mundohet të shfrytëzojë gjuhën e vendit të vet në shpjegimin e fjalëve aty, qoftë edhe duke ba transformime të pa lidhje e që nuk afrohen me njana tjetrën, apo duke përdor fjalë shumë rrokshe, (që në shqip asht një fjali e shkurtën), të cilat i transformojnë simas mënyrës së tyne, që mu më duken të pa sakta.

Shumë miq e dashamirës, masi lexuen librin “Emnat ilir”, më këshilluen, që çdo emni t’i kushtoja 2-3 faqe libri, por mendoni ju lexues e miq të dashtun. Nëse në librin tem të parë kishte afërsisht 4 000 emna, për dy faqe e gjysëm për çdo emën, do bajshin plot 10 000 faqe dhe do i dilte çmimi i naltë dhe i pa përballueshëm për tu stampu, për tu ble e për tu lexu nga çdo njeri dhe një libër, që nuk do e mbaje në duar. Edhe nëse do e bajsha me volume, do dilnin plot 20 volume me nga 500 faqe, një punë shumë e lodhshme dhe një shpenzim shumë i madh, që vetëm institucionet shtetnore mund ta përballojn e ta ruejnë në bibliotekat e shtetit.

Shof, që në këte libër të ri, po analizoj mbi 20 mijë emna të ndryshëm, të përdorun gati në të gjithë globin toksor. Vetëm si radhitje, ku çdo emën ka një rrjesht, më krijojnë gati 500 faqe me format A 4. Prandaj i detyruem nga idea që librin të mos e baj shumë volumesh dhe të përdorshëm nga shumica e popullit, shpjegimin e emnave do e baj me sa ma pak fjalë e rrjeshta që të jetë e mundun, vetëm duke vendos shenjën e barazimit e do them kuptimin, edhe simbas dialektit që ai emën përmban, përndryshe ky libër do më dalë me shumë volume, me kosto të madhe dhe jo praktik për shumicën e njerëzve.

Në përgjithësi emnat kanë qenë ndërtu, që të përdoreshin njilloj për të dyja gjinitë, sepse ishin një fjali e shkurtën e shprehëse, prandaj në këte libër nuk jam zgjat, që të jap e të shpjegoj format femnore, ose mashkullore të sotme.

Gjatë kësaj periudhe, midis dy librave me shpjegimin e emnave, kam pa që gati të gjithë emnat nëpër botë, marrin kuptim me gjuhën shqipe, përveç emnave kinez e të tjerë të ngjashëm në Azi, për të cilët nuk jam në gjendje ti shpjegoj, sepse nuk kam njohuni për ato gjuhë, por që miq të mij, që i njofin

ato më thonë se edhe ke ato gjuhë ka fjalë që shpjegohen me shqipen. Gjthashtu, në shumë fjalorë emnash që janë botu në Shqipni, shifet mania që tia largojnë e tia humbin kuptimin emnave, që ia jep gjuha shqipe, duke i quejt: Emën arap, emën turk, emën gjerman, italian etj, që për mu asht gabim, sepse të gjithë ato emna janë atlantideo-pellazgo-shqiptar e marrin kuptime të bukura vetëm me anën e gjuhës shqipe.

Disa, në interent, direkt ose indirekt më kundërshtojnë duke thanë se po e thjeshton e po na e ban të kollajshme çdo shpjegim me shqipen dhe ata janë mohuesit kryesorë, që çdo argument duen ta largojnë nga shqipja duke nxjerrë argumente të largëta, të ngaterrueme e të pa pajtueshme me shqipen, si e si tia ulin vlerat.

Disa më bajnë vërejtje për përdorimin e dialektit GEG në librat e mij, si dialekt “i trashë”. Un u thashë e u them atyne, se gjuha ka ngjyrat dhe muzikalitetin e vet dhe çdo dialekt ka shkallën e tij muzikore dhe ngjyrore e të gjitha së bashku krijojnë vizatimin dhe simfoninë madhështore të gjuhës shqipe, që nuk ka asnjë gjuhë tjetër. Me një notë muzikore, dhe me një ngjyrë sado të ambla e të buta të jenë, nuk krijojnë sinfoni apo një vizatim të bukur.

Ene në krijimin e emnave të ndryshëm, që të ruhet muzikaliteti dhe bukuria gjatë përdorimit të atij emni, shof që janë fut fjalë një rrokshe nga disa dialekte bashkë.

Standartizimi dhe njisimi i gjajnave, me kalimin e kohës do shkatërrojë gjuhët e kombeve të ndryshme, duke lanë të dominojë vetëm një gjuhë: Atë të “ma të fortit”, kur në fakt duhet të dominojë ajo gjuhë që asht çelësi i gjithë gjuhëve të tjera e që e them me bindje që asht gjuha jonë, gjuha shqipe. Edhe shumllojshmënia e gjuhëve dhe dialekteve kanë bukurinë e vet.

Gjuhën shqipe e shof me këto dialekte: 1-Gegnisht ku dominon përdorimi i zanoreve “a dhe o”: =Asht, osht; Hana, Hona. 2-Arnautishtja, arvanitishtja, çamërishtje dhe dialekti i myzëve:=Iç, iq, is; yç, yq, ysht. Ina, Yna; Hina, Hyna, (që sot i thërrasin: Hena, Hëna). 3-Toskënishtja ku dominon përdorimi i “e-ë”:=Esht, është. Hena, Hëna; 4-Dialekti latin:=Uç, us, ush, usht, uq; Una, Huna, Luna.

Miq të ndryshëm, që kanë shëtit nëpër botë dhe që kanë lexu librin e parë me “Emnat Ilir”, më kanë taku, ose me kanë çu mesazhe duke më inkuraju e duke më thanë, që edhe në Europë, në vende të ndryshme të Azisë, të Afrikës, në ishujt e Paqësorit, në Polinezi, në Mikronezi, në popujt e vjetër të Amerikës, në Irlandë, ke baskët, në Sardenjë etj ruhen shumë fjalë, emërtime vendesh dhe emna njerëzisht e kafshësh, plotësisht të shpjegueshëm me gjuhën shqipe.

Poeti, shkrimtari dhe studiuesi nga Kavaja, zoti **Abdulla Tafa** më tha një ditë se shkonte shpesh për vizite në ishujt Havaj (ha vaj, a vaj, à-ba-aj, etj) e në

Irlandë, ku kishte has fjalë të përditëshme, emna njerezish, rrugësh e vendesh si në Shqipni. Simas atij, edhe gjuha e Irlandës i dukej si një dialekt i shqipes. Mjeshtri mason, zoti **Maksim Zotaj**, i cili ka kalu 15 vjet në Amerikë dhe z. **Bashkim Kllloboçishta**, një mik tjetër me banim në Amerikë, më kanë thanë, që gjuha e popullsisë autoktone (vendase) e amerikanëve të vjetër (indigjeneve), ka shumë ngjashmëni me shqipen e sotme. Nëse mendohet se sa mijëra vjet kanë që jetojnë në Amerikë ata popuj të izoluem, shifet lidhja e vjetër dhe mrrekullia e popullit shqiptar, që në qendër të Europës ka qenë mospërfillës ndaj ndërhymses së gjuhëve te tjera dhe e **ka ruejtë me xhelozi gjuhën e shejtë të yllorëve, të cilës i takon, të paktën qysh prej 12 000 vjetësh, që asht data e fundosjes së Atlantidës e jo disa qinra vjeçare siç pretendon ndonji studiues.**

Në shqip yllorja lidhet me yjnoren, hyjnoren, që kuptohet si gja e shejtë. Në kujtesën e popullit asht ruejtë ndodhia e lashtë kur yllorët, yllirët-ilirët e parë tanët prunë në tokë edhe shejtëninë, që populli e njëf edhe sot si hyjnore=Yj-nore=gja e shejtë= e ardhë nga yjet.

Në internet kam zbulu, që etruskët nuk e kan pas përdor germën”d, dh,” por “t” dhe në vend të zanoreve “a, o” përdornin shpesh zanoren “u”, jo vetëm në të folmen e përditëshme, por ene në shkrimet e tyne. Në zonën bregdetare të Kavajës, nga Golemi e deri në derdhje të Shkumbinit, gati të gjithë katunarët atje nuk e përdorin germën “**D, dh**” dhe sforcohen shumë kur thonë psh: bardhë e thonë barrr. Bardhak e thonë barrak, e verdhë = e verrr, gardh=garr; dhondër=rronërr, ose honërr, e dhosh=e osh etj dhe nga kjo mënyrë të foluni i duket se bahen qesharakë ke ndiguesit, që e përdornin germën “D, DH”. Sot po humb ky dialekt, por u them atyne, dhe gjithë shqiptarëve, që përdorin dialektet e vjetër të krahinave të tyne, që duhet të jenë krenarë që i kanë ruejtë gjer në ditët e sotme këto dialekte, sepse i kanë si pasaportë, gja që tregon që janë popull shumë i vjetër aty ku janë. Po ashtu edhe përdorimi i qeleshes. Disa krahina i thonë: Qeleshe= qileshe= quleshe=qyleshe= q’el-esh=qiell esht=që el esht= që yll është, ku: el=il=ul=yl e më del simbol i originës së yllorëve tanë: Ela=Ili=Ulli=Ylli me të gjitha format e përdorme në vendin tonë.

Kush lexon libra të vjetër të ashtuquejtun grek (në fakt duhen quejte pellazgo-helen, ku në shqip Elenet=Elin=el lin=yll lin, yll lindun, ose yll-a ynë), shef se të gjithë emnat atje janë emna të përbanë e me kuptim në shqip dhe s’kanë pse quhen grekë, sepse Greqia nuk ka pas ekzistiu në ato kohë, por ka qenë Pellazgji, Iliri, Epir, Elem, Elim, Ellen dhe Elini, Yllini (El-leni: El-lini=e, il, yll lindi, ose nëse thuhet: el-ini=ylli inë, ylli jonë), e shpjegohen shumë mirë me shqipen.

Gjuha shqipe ruen deri më sot lidhjen midis fjalës “el”, “il e yll” në fjalë të ndryshme psh: Angjell=engjel=engjil=ingil=ungil=ungjill (*enxhil, inxhil*)=engjull=engjyll dhe: Dielli=Dilli ku: Di-el-li=Di-il-li=Ditunia, drita yllore

lindi; si dhe dita: “e die!”=e di=e diil, ku: di-el=di-il etj. Kur isha i vogël ndigjoja shpesh pleqtë, që emnin Ylla e thonin Ella. Sot e ndigjoj ma rrallë. Me greqishten e sotme nuk shpjegohen asnjë fjalë, emën apo domethanie të lashta, sepse ajo asht një gjuhë e sajume dhe e përpunume nga kisha bizantine, e ashtuqejtuna “greke”, që në fillim të jetës së saj ka shkatëru e damtu me mijëra faltore e ndërtesa te lashta në hapsinën pellazgo-iliro-arvanito-shqiptare, duke ba gëlqere me mermerin e monumenteve, dhe mure me copa skulpturash e muresh të atyne tempujve të lashtë, që i quanin pagan, e i përkisnin popullsisë pellazge. Autorë të ndryshem, si Aristidh Kola, Robert D’Angely etj, kanë shkruajtur se kanë gjetun nëpër arkiva letra (korespondenca) e drejtuesve të kishës ortodokse bizantine (“greke”), që urdhnonin prifta të ndryshëm që të digjinin e shkatërronin çdo arkiv të vjetër të ndodhun nëpër manastire e kisha katolike që ata uzurponin. (Kisha katolike ndihmoi shumë në mbajtjen gjallë të shkrimeve në gjuhen shqipe në krejt Ilirinë). Nëse dikush nuk pranonte e kërcënonin, e dënonin me vdekje ose e hiqnin nga puna. Dihet se kjo gjo po vazhdon deri në ditët tona, kur kisha ortodokse greke, po zaptun edhe varrezat e popullit shqiptar, për ti deklarun “greke”. Me lekët e Europës, po ndërton kisha e shkolla me stilin grek, e shpesh shemb e shkatërron ato të ndërtueme nga populli ynë. Po me manine e asimilimit të popullit shqiptarë, janë sjell edhe turqit myslimanë e sllavo-serbët ortodoksë me shqiptarët, që për interesat e tyne kanë zhduk e shpërngul me force popullsinë shqiptare në krahina të ndryshme, edhe pse ishin myslimanë apo kristianë.



Kristianët duke shkatërru thesaret e lashta kulturore.

Në librat e vjetër të Homerit: ILIADA (Ili a dhanë) dhe ODISE-A (o dis-è= osht i dijsëm, i ditun), ene pse të përpunuem me maninë për t'i ndryshu nga origjinali, shumë shprehje, emërtime vendesh, emna njerëzish e sendesh shpjegohen e marrin kuptim të plotë vetëm me anën e gjuhës shqipe. Kam rilexu prap librat, historitë, legjendat, dramat, komeditë dhe çdo libër të ashtuquejtun “grek të vjetër” e të popujve të tjerë të lashtë, që të mbledh emnat atje me kuptimet e bukura e domethanëse në shqip, që duken sikur të jenë kriju me shqipen e folun sot e i shtova në këte libër. Shpjegimi i atyne emnave në këte libër dhe i shumicës së gjuhëve të lashta, të zhdukuna ose jo, më krijonë bindjen se gjuha shqipe asht:

Ma e vjetra, ma e pa ndryshuemja dhe çelësi i gjithë gjuhëve të botës.

Kur isha i vogël, dëgjoja bisedat midis të moshuemve dhe më kujtohet kur ata shohisnin ndonjë proverb, emërtim, formulim, apo domethanie të lashtë, shpesh përsëritnin:

–“Ka qenë ma e ditun bota në lashtësi, por asht kthy mrapsh, e sot asht ma e mrapambetun.”

Kishte ngel në thellësi të kujtesës së trunit të tyne, që bota e lashtë ka qenë ma e zhvillueme se ajo e asaj kohe (mesi i shekullit XX), prandaj nuk më çudit fakti që emnat të jenë ndërta në lashtësi, si fjali të shkurtua kuptimplote, në këte mënyrë që po mundohem ti zbërthej unë.

Emnat ishin fjali të shkurtua e preçize, me shumë domethanie, që mund të përdroreshin për të dyja gjinitë njëloj. Fëmija duhej të ndihej krenar për emnin që mbante. Përmbajtja e emnit bahej një udhërrëfyes për drejtimin, që do ndiqte në jetë ai fëmijë kur të rritej.

Në shumë shkrime të vjetra asht shkruajtë vetëm me bashkëtingullore, dhe zanoret shtohen në forma të ndryshme nga studiues të ndryshëm, që këtu marrin kuptim të plotë në shqip. Në përkthimin që po i baj librit: “Nuk ka asgja hyjnore në Bibël” (Non ce creazione nella Bibbia), të z. **Mauro Biglino**, merren në analizë fjalë të vjetra të përdoruna nga ebrejtë ke Bibla, por që autori thekson, se janë fjalë para-ebreje e që në shqipen e sotme marrin kuptim të plotë. Shpesh herë autori përsërit thënien e tij dhe të autorëve të tjerë të përmendun në ate libër, se në lashtësi emnat e njerëzve, kafshëve, vendeve etj, nuk ishin thjesht fjalë emërtuese, por një fjali e shkurtën, që shprehnin funksionin apo veçantinë e atij njeriu, apo asaj gjëje që e kishte emnin. Ai libër asht gati e do e botoj bashkë me këte libër.

Në internet, në shtyp e në diskutime shkencore shof të bahen debate të mëdha në lidhje me shkrimet e gjetuna në gurë të ndryshëm. Për shumë nga këto shkrime, kam rezerva, sepse besoj se në shumicën e rasteve janë ba nga gurgdhendës analfabetë, që e kishin mësu gjuhën ”me të vjedhun” dhe kanë shumë pasaktësi.

Më kujtohet adoleshenca ime, kur sapo fillova punë si gjeometër në ndërmarjen komunale të qytetit të Kavajës. Aty gjej dy gurgdhendës të

moshuem, që merreshin edhe me gdhendjen e gurëve të varreve. Ishin gati analfabetë. Fjalët në shkrimet e tyre nuk i ndanin nga njana tjetra, pa pika e pa presje me mungesa germash dhe shpesh herë germat i shkruanin mrapsh ose horizontalisht.

Puna ndryshoi menjherë, kur aty u punësua një ish prift me shkollë. Shkrimet u bënë të bukura, preçise dhe shprehëse.

Nga shkrimet e vjetra vlerësoj ata që baheshin me porosi të mretënve, perandorëve dhe faraonëve, të cilët ashtu si sot, ishin të organizum për të shkruajt, për të redaktu e korregju gabimet.

Disa fjalë një rrokshe të shqipes

Disa fjalë shqipe një rrokshe me të cilat kombinohen të gjitha fjalët e gjuhëve të Europës e të shumë popujve të tjerë nëpër botë po i paraqes ma poshtë dhe janë:

1.-Vendosje të zanoreve-folje dëftuese:”**à, è, ë, ì, ò, ù, y**”, në vend të foljeve përkatëse shqipe: **à, aç, açt, aq, as, asht; è, eç, eq, es, esht; ë, është, ëç; ì, iç, icht, iq, is, isht; ò, oç, oçt, oq, os, osht; ù, uç us, usht; yç, yçt, yq, ys, ysh, ysht.** (Mendoj se janë përdorur format: Ax, az; Ex, ez; Èx, èz; Ix, iz; Ox, oz; Ux, uz; Yx, yz). Në lashtësi dhe sot, këto folje shumë të përhapura nëpër botë, por që e kanë ruajtur shumë mirë kuptimin e zanafillës në shqip, ka pas kuptimin, e të qenit, të lindjes, të dritës, të jetës, të shejtës, të hyjnore, të Zotit. “Asht, esht” ka ene kuptimin e rrashtit.

2.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**A**” me kuptimi: I-e parë, siç asht edhe germa “**a**”, me të cilën fillojnë alfabetet.

3.-Emna që shoqnohen me fjalët: “**A,b**” që ka pas kuptimin e ditunisë. Njeri me abetare të mësueme, me “**a,be**”, që din shkrim e këndim.

4.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**ah**”, me kuptimin: i-e fortë si pema e ahut. Gjithashtu populli ynë, fjalët “**ah, eh**” i përdor me kuptimin e frymës së shejtë, të dëshirës, të shpirtit.

5.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ak, ek, ok, hak, hek, hok**”, në rregull, i-e drejtë, i-e arsyeshëm-e etj. Psh: I jep **hakun**.

6.-Emna që shoqnohen me fjalën italo-shqipe ”**al, ol, ali, oli**”, krah për fluturim, por ene me kuptimin e engjyllit, melek, melek, apo të shpirtit yjnor që me krah fluturon në qiell. Engjyjt nëpër faltore paraqiten me kokë njeriu dhe me krahë. Ekzistojnë ene engjyjt në formën fluturake, fluide, fluturuese, në formë mjegulle, të cilat prezantohen me anën e bashkëtingullores “**f**”.

7.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe:”**am, em, om, um, ym**”, me hangër, me dhanë, me dasht, me dëshirue me dashunue, dashni etj.

8.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**am, em, om, um, ym**”, e ama, mama, moma, muma. “**Em, hem**” së bashku me fjalën “**ene**”, në dialektin geg përdoren në vend të lidhseve: **dhe, edhe**.

Gjatë zbërthimit të kuptimit të emnave, fjalët-rrokje ”**am, em,om, um, ym**” më dalin me disa kuptime, që janë: = i-e dhanë, i-e dëshiruem-e, i-e dashtun-a, nganjherë edhe me kuptimin hyjnor, të Zotit, që asht i dashtuni i të gjithëve.

9.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**an, en, in, on, un**”, janë, jen, jin, jon, jun, me qenë.

10.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**an, en, ën, in, on, un, yn**”, Ana-Hana, Ena-Hena, Ëna-Hëna, Ina-Hina, Ona-Hona, Una-Huna-Luna dhe Ani,

Eni, Ini, Oni, Uni, Yni, (në italisht: L'una). Emni i Hanës duhet të ketë qenë edhe në format: Un-a-i, Hun-a-i. In-a-i, Hin-a-i. Yn-a-i, Hyn-a-i.

11.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ap, ep, ip; nap, nep, nip**”, me dhanë. Ap=hap=me hap. Mendoj se mund të kenë qenë edhe në format: “**up, yp**” dhe “**nup, nyp**”.

12.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**ap, hap**”, hap, me hap, hapi, ecja.

13.-Kombinime me fjalët: “**ar, or e flori**”, që shprehin të njëjtën gjë në shqip: njëvleftshmëninë me metalin e çmueshem të arit. Shpesh shkëmbehet edhe: **Ar=er=ur**.

14.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**at, et, ot, ut; tat, tet, tot, tut**”, “ATI-ATA”, tata, baba-mama”, prindi si dhe me kuptimin e pjekunisë, matunisë, vjetërsisë në moshë. Përdoret për të emërtu edhe **ZOTIN**, **AT-i** i të gjithëve dhe mësuesin; Thot=ai që thotë, ai që të mëson. Në disa emna më del edhe në format: it-yt=iti-yti, që më japin kuptimin: y-t'ì=hy të isht. Në shqip përdoret edhe si mbaresë e shumësit, psh: Top—Top-at, top-et. Qepë—Qep-ët etj.

15.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ba, be, bi, bo, bu, by,**” me ba, me be, me bo, me bërë, i-e ba për mirësi.

16.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**be**”, i-e besës, bej-a, kont-e, zotni-zonjë. Emnat-tituj: Be, bej-a dhe ag-a, në të kaluemen i shof të kenë qenë me kuptim për të dyja gjinitë, pamvarësisht se sot po përdoren vetëm për meshkujt.

17.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**bi, by, bir, byr, bur, bil**”, bi=bin-mbin=min= me mbirë, biri, bijtë, fëmijët. Bi=biri e bija. Emnin në çamërishte “bil” nëse e ndaj në : Bi-il shof kuptimin e lashtë, ku fëmija mendohej se kishte ra (bie) nga yjet, ose: mbiu ylli. Fizika kuantike sot e pranon se organizmat e gjalla në tokë kanë në trupin e tyre të gjithë elementët, që ndodhen tek yjet e në Gjithësi. Në italisht biri quhet: Fil=F-il=engjyll-a yllor-e, engjyll-a fluturak-e yjesh.

18.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**bi, by**”, bie, ra nga qielli.

19.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**br**”, brinat, bringat, brirët mbrojtës.

20.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ça, çe, çì, çy**”, me ça në jetë, me çy, me fitu, me përfitu, me udhëheq. E çe-u, e çì-ti, e çì-u, e qi-u, e çy-u, e shçiu, e shçiu, e shçyu (shçy-p'e=shçy-po-esht). (Besoj se nga kjo fjalë e ka origjinën edhe përshëndetja italiane, që po bahet gjithë botnore: “ciao”=ça-o, çaj në jetë, që ça në jetë, që nuk e ndal asgjë).

21.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ç'a, ç'e, ç'ë, ç'i, ç'o, ç'u, ç'y**” me kuptimet: ç'është, ç'esht etj; K'a, k'e=kah është, kah është; Që (qi)është, që (qi) është etj; Qysh është, qysh është etj; Si është, si është. Në dialekte të Shqipnisë kemi: Ç'ar-ò=ç'ere ò=ç'e ò=ç'ëç=ç'iç=ç'oç=ç'uç=ç'yç=ç'farë është.

22.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**çap, kap**”, me marrë, me kap, kafshata, ose hapi i njeriut, e ecmja (**çapit**=ec, lëviz, hudhi kamet), ose çap=çjap.

23.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ço, çu**”, me çu, me dërgu, me u çu në kambë, me u ngret, i-e ngritun-a, i-e zgjutë, i-e naltësuem-e etj.

24.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**çorr, çirr**”, me çjerr, por e barazoj edhe me=korr. Nëse=Ç’or=Çfarë ari.

25.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**da, de, di, do, du, dy = dha, dhe, dhi, dho, dhu, dhy**”, me dhanë, (me dhuru, me dhyry=Dhy-yr-y=kur jep, shejtënohesh e bahesh hyjnor).

26.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**da, dha, de, dhe**”, dheu, toka, i gjithë globi. Duhet të ketë qenë edhe në format: “**do, dho, du, dhu, dy, dhy**”.

27.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**da, di, do, dy**” me nda dy copash, numri dy.

28.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**dal, del, dil, dol, dul, dyl**”, me dalë në jetë.

29.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**di, dy, dhi, dhy**”, dita, ditunia, dielli.

30.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**do, da, du**”, don, dua, me dasht.

31.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**dra, dro, dru**”, që në shqip i vlerësoj të njivlefshme me fjalën “droje, druj” i-e ndrojtun-a, i-e matun-a, i-e mençun-a. Drujt dhe pemët. Nëse vazhdoj t’i ndaj këto fjalë e t’i plotsoj me zanoren, që u mungon, mendoj se më dalin dy fjalë njirokshe me kuptim gati të njëjtë me to: D(i)-ra=di-ro=di-ru=ditunia ra nga qielli, ditunia rron ke ata njerëz me droje, të drojtun, të drujtun, ke druidet.

32.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**dri, dry**”, drita, ditunia, që të ndriçon mendjen. Nëse i baj: d(i)ri=d(i)ry=di-ri=di-ry=dituni rinon.

33.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**ec**” me ec, me lëviz si dhe “**è, eç, esh, esht**”, me qenë.

34.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ek, ik, hek, hik**”, me heç, me heq: me hiç=me hiq= me largu, ose **ek=ik, hik**=i-e ikun-a, i-e shëtitun-a.

35.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**el-a, il-e, yll-a**”

36.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**em, im, om, um, ym**”, me dhanë imi, imja.

37.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**er**”, ajri, era, aroma, flladi.

38.-Emna që shoqnohen me bashkëtingullore “**f**”, që japin ndjesinë e fluturimit, shejtënisë, shejtërisë, engjyllit që fluturon, diçka si mjegulla, si drita që qëndron pezull në qiell. Në formën “**fe**” e kuptoj si: njeri me fe, me besim hyjnor, fluturak-e, ose “**fi**”, fije lidhëse midis njerëzve, shpirtnave, gjithësisë, me Zotin e me yjet. Në emnat **Fedel** dhe **Fidel** shof se “**fe**” dhe “**fi**” kanë kuptimin e fesë, besës, fije lidhëse shpirtnore.

39.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**fer, fër, fir, for, fur fyr**” me kuptimin e birës, gropës së vogël.

40.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**g, ga, ge, gi, gu, gu, gj, gju**”, me kuptimin e gjiut, gjindjes, rracës së një gjaku. Mendoj se “origjina” ndiqej qysh nga koha e matriarkatit, ku të gjithë fusin në hasapë nonmadhen, ku kishin pi gji të gjithë, ku e kishin origjinën (ori-gjina) të gjithë.

41.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ga, ge, gja, gje**”, që bahen: gja, gjia, gjie, me kuptimin e gjithësisë (gjea, gjeo), ose gji-à, gjasendi asht, dikushi asht, gjinia, gjini femnor.

42.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ha, ho**”, me hangër. Në dialekte “ha, ho” ka kuptimin= ha jepi, ho bone, shtyje. Italisht = me pas. Shpesh, “h”edhe nëse hiqet nuk ua prish kuptimin zanoreve.

43.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**hi, hu, hy**” hij-a, hini=hiri i zjarmit, me hy mrenda, por edhe “hyjnor-e”. “Hu” quhet edhe huni i gardhit, i kufinit etj. Në kanun, kufini asht i shejtë.”Hu” quhej edhe Sfinksia.

44.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**i, y**”, il, yll, hil, hyll, Nganjihërë:”u, ul, ull” ose shkurtim i foljeve: iç, is, isht, iq; u, uç, us, usht; y, yç, yq, ys, ysht. Në shumë emna e fjalë, përdorimi i zanoreve “**i, y**” në fund të fjalëve u jep atyne kuptim mashkullor, por ene yllor, hyjnor.

45.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ik, ek, ok, uk, yk**”, i-e ikun-a, i-e shëtun-a, shtegtar-e, me dituni, që ka pa botë me sy e ka mësu shumë gjojna.

46. Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**i, in, ni, u, una, uno, një, nja, nje, një, njo**”, numri një, i-e parë.

47.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**in, en, eni, ini, uni, yni**”= i-e jonë. Në italisht, emnat që mbarojnë me “**in-a**” japin kuptim përkëdhelës dhe të fëmijës së vogël.

48.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**in, en, yn, hin, hyn**”, me hy mrena, mbrenda.

49.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ip, ep, op, up, yp**”, me hip, me hop, me hyp, shqiponjë.

50.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ir, yr, ur, hir, hyr**”, me hirësi, me bukuri hyjnore.

51.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**it, ot, ut, yt**”, joti-jotja, yti-ytja.

52.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**janë, an, jen, en, jon, on**”, me genë, me ekzistua.

53.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe:“**ka**”,si kau, me forcë e bukuri kau.

54.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ka, ke, ki, ko, ku, kam, kem, kim, kom, kum**”, me pas. “Ko, kho, khu” në dialektin geg don të thotë “këtu” psh: Ec ko=ja kho=ja khu=ja t’t’u=ec këtu.

55.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe:“**kap, kep, kip, kop, kup, kyp** (kaptoj= keptoj= koptoj= kuptoj; me kap)”, në italisht: **cop-copare (kop-kopare=copë, me coptu)**, në shqip “**çap**”, me kap; “**cep-kep-skep; cep-toj, cop-toj**”. Besoj se nga format: **kap, kep, kip, kop, kup, kyp**, krijohen: **shka-shkap; shke-shkep, shki-shkip, shku-shkup, shky-shkyp=shkiponja**

=shkyponja. Ka dialekte ku “k” zavendesohet me “q” nga ku: (qap, qep, qip, qop=qok, quk-qup, qyk-qyp); nga ku rrjedhin: shqi, shqy=shqiponja=shqyponja).

56.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ki, ky, kio, kjo; qi, qy, qo**”. Duhet të ketë qenë edhe në formën “**ku=qu**”=“**ky=qy**”. Zakonisht emnat, që përbahen me këto fjalë, japin kuptim për gjininë mashkullore, psh: Kiriako=Qiriako=Qyriako=Ki (ky, qi, qy) iri asht ko, ose; Qiri a ko=Qiriu asht ko. Akili=Aqili=A-ki (qi) ili. Në gjininë femnore në shqip bahen=Kjo, qo. Nëse i kuptoj si: Q’i, q’y=k’i, k’y=Që isht=kah isht.

57.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**kra, kre, kri, kro, kru, kry; cra, cre, cri, cro, cru, cry**”, kaptina, koka, krea, kreo, kreu, kriet, kryet. Nese vendosim apostrof ne fjalet: C’ra, c’re=c’ri=c’ro=c’ru=c’ry=ç’ra nga qielli, ç’rinon (jetën), ç’ro=ç’ru=që rron.

58.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe:“**la, le, lë, li, lo, lu, ly; lan, len, lën, lín, lon, lun, lyn**”, me lanë, me lonë në jetë, me lë, me lind.“La” shqip kuptohet ene: Me la, me larë. Li, kuptohet ene: Me lidh.

59.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**lum, lym**”, me kuptimin: I-e lumtun, ose lumë me ujë.

60.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ma, me**” me mbajtë, me u mèt, me shtang, me u paksu.

Në format”m’a, m’e, m’i, m’o, m’u, m’y,” kuptohet si: Më àsht, më esht etj.

61.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ma, mo**”, me kuptimin: më len (më ler), mundet, ka mundësi, tashti: mo ta ndez=mundet ta ndez-më len ta ndez. Ho mo=jepi tashti

62.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**mar, m’ar**”, i-e mbarë, mban ar, ose me marrë.

63.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**mat, met, m’at, m’et**”, me et, mi et, mbiu-lind i et, me matuni, i-e mençëm, ose: mbet, me ngel.

64.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**mi, miu, mbi, mbiu**”, me mbi, me lind, ose: mbi, sipër.

65.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**mir**”, i-e mirë. Në dialektet e veriut kemi: **Mair, majr, meir, mejr**=mirë=M’àsht me hirësi=Më është me hirësi.

66.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**n’a, n’e, n’ë, n’i, n’o, n’u, n’y**”, me kuptimet: Na àsht, na është (ne është) etj.

67.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**nam, nem, nom, nap, nep, nop**”, me dhanë, i-e ndershëm-e, me nam-us=me ndershmëni asht, i turpshëm asht.

68.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe:”**nè, nej, ne-a-u**”, ndeva (troben), ndenja, vendos-a.

69.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ni, ny, një, nja, njo, nji**”, me kuptimin: njishi, njëshi, i-e parë. Kuptohet edhe si: ”n’i, n’y”=Na isht.

70.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: ”**ni, ndi**”, ndjej, ndjenjë, me ndjerë, me ndigjue,

- 71.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**nir, nur; n’ir, n’ur**”, me bukuri shumë, me bukuri hyjnore, me hirësi, me nur.
- 72.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**on, yn**”, joni, yni, (jona, yna).
- 73.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**pa, pe**”, i-e bredhun, i-e shëtitud, që ka pa botë me sy.
- 74.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**pa, pe**”, i pashëm- e pashme, me paraqitje.
- 75.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**pa, pe, pi, po, pu, py, paj, pej**”, pasha, per, prej. Përdoret edhe si: P’a, p’e, p’i=Po asht=Po esht=Po ist.... etj=Që është.
- 76.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**pa, pe, pi**”, me pi dituni, me mësu, i-e përsosun-a, (i-e **pirs**osun-a), i-e mësuem-e etj. Në dialekt **Paj, pej, pij**=me pi. Përdoret edhe në formën: Paj zotin=Pash Zotin=Për Zotin=Për atë Zot.
- 77.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**plat, plot, plut, plyt**”, me qenë plot.
- 78.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**pra, pre, pri, pry**”, me pre, i-e premë, i-e përcaktuem, lindun për të ba gjona të mira, i-e vendosun. Pre=prej=nga. Prijës.
- 79.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**pra, pro, pru**”, me pru, përroi. Populli thotë: Pa pra, pa pro, pa pru=Pa pushim, ashtu si përroi, që bie ujë pa pushim.
- 80.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**pri**”, me pri, me drejtu, me udhëheq.
- 81.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**Qa, kla**”, me qa. Nëse e baj: q’a=që asht.
- 82.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**qo, qu**”, i-e zgjutë, i-e qutë, me u qu nga gjumi, kur të ndriçohet truni nga një mendim i mirë. “**Qe, qi, qo, qu**” i shof të përdoruna edhe në vend të “që”, psh: Qu es=që esht=qi esht. Kemi: Kështu=qashtu=qështu. Kebab=qebab.
- 83.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ra, re, ri, ro, ru, ry**”, bie nga nalt poshtë, por edhe jeta që bie nga yjet, që rron, që rinon gjindjen e çdo gjë nëpër tokë. Shpesh shkëmbehen me “la, le, li, lo, lu, ly”, me lind dhe krijojnë lidhjen yjnore: Lindje që ra, që bie nga yjet, nga qielli.
- 84.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**re**”, reja e shiut.
- 85.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ri, ry**”, rinon.
86. Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ra, re, ri, ro, ru, ry; rri, rro, rru, rry**”, me rrojt, me rinu (me rinu jetën), me nejt.
- 87.-Përdorimi në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera i bashkëtingullores “S” për të dhanë ndjesinë e mohimit, rrëshqitjes për tu largu, për mos me e kry një veprim. Mendoj se bashkëtingullorja “S”, në formën e gjarpnit e jep shumë qartë ndjesinë e rrëshqitjes, formës dhe fishkëllimes së gjarpnit.

88.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**saj, sej, sij, soj; sa, se, si, su, syu (edhe: çj, çu, çy)**”, por që don të thotë: ka sy, ka paraqitje, asht i pashëm, asht soj i bukur, asht racë, gjini e bukur.

89.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ser, sërë, sir, soj**” me kuptimin e shkallës shoqnore.

90. Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**shçi, shki, shqi, shqy, shky**” me shqye.

91.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ta, tha; te, the; ti, thir; tot, thot; tut, thut; tyt, thyt**”, me thonë, me thirr, mësues-e.

92.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**ter**”, me tha diçka: rrobat-leveret, trupin etj.

93.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**thy, thyni**”, filizi i ri i bimëve.

94.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**thy**” me thy, me coptu, me mund.

95.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**tjek, tir, tiq**”, tërheq.

96.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**tra**”, tra që mban gjithë shtëpinë.

97.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**tru**”, me tru, me mend, me dije.

98.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**turr**”, me vrapu, me sulmu.

Nëse=T’ur=Të usht ur. Kur turesh, kur lëviz, krijon një segment, një urë.

99.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**uk, yk**” : i-e fortë si ujku.

100.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**ul**”, i-e ulët, i-e urtë, me mend, kokë ulët nga pesha e mendimeve. Shpesh herë, në kombinime emnash, më lidhet ene me kuptimin: el=il=y=ull, kështuqë ul=yllor-e=hyjnor-e.

101.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**u, un**” me kuptimet: usht=është, njishi, Hana.

102.-Emna që shoqnohen me fjalën shqipe: “**ur**”, urë lidhëse midis njerëzve dhe midis njerëzve dhe Zotit apo Gjithësisë. Besoj se kjo asht ene rranja e fjalës sonë: “Ur-t’i”, ur të isht, me kuptimin e njeriut të bekuem, urata, të urtë, të mençun, që din shumë, që lidh njerëzit me Zotin. Në shqip një njeriu të bekuem i thuhet edhe: e **uruara**, i **uruari**. Mendoj se lidhet edhe me **ir=yr=ur**, ku njerëzia me hirësi hyjnore bahet urë lidhëse shpirtnore.

103.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**va, va-u, vi-a, vy**”, vend kalimi (vend ku kalon lumi, njerëzit, kafshët, bagëtia etj).

104.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**va, ve, vë, vi, vu, vy**”, që nëse i baj: “ba, be, bë, bi, bu, by” i mendoj të barasvlefshme me foljen: Me ba, me be, me bërë, me besë.

105.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**ve, vë, vo, vu, vy**” veza, me vendos diçka, me u vendos.

106.-Emna që shoqnohen me fjalën: “**vi**”, që shkruhet në alfabetin latin “**bi**” e në alfabetin cirilik lexohet “**vi**”, formë e cila shpesh na vjen gjer në ditët tona, por me kuptimin shqip “**bi, bir.**”

107.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**vla, vlla**”, të cilët i mendoj se rrjedhin nga: **bi-la**.

108.-Emna që shoqnohen me zanoren shqipe:”**Y, yll, hy**”, yll, yjni, hyjni, i-e zbritun-a nga yjet. (Ma sipër kam thanë se janë bashkë: e=i=u=y=el=ël=il=yl=ul=ell=ëll=il=ull=yll).

109.-Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**yp, op, up, ip, ep**”, me hyp, me hop sipër, me kërcy edhe me kuptimin: Mbi të tjerët, i **siperm**, shqiponjë.

110.- Emna që shoqnohen me fjalët shqipe: “**za, ze, zë, zi, zo, zu, zy=xa, xe, xë, xo, xu, xy**”, me zanë, me nzanë, me nzanë, me mësue, me kap, me nis një punë, me gatue, me u mbars e me u formu në trup të nanës, me zanë brumin, kosin etj, ose: zani, zoni, zëri. Me kap, me xanë, me zanë diellin, me u nzi (nxi), me u zanë etj etj...”Zi” kuptohet edhe si ngjyrë e zezë, por edhe kur mban”zi”, dmth, që vishesh me ëe zeza kur ke ndonji pikëkëllim apo vdekje. “Zi” përdoret edhe kur heq keq, kur vuan, psh: S’ka ma zi=s’ka ma keq.

.....etj etj ...dhe shumë e shumë fjalë e shprehje të tjera një rrokshe, që shpjegohen me anën e gjuhës shqipe dhe që krijojnë me mijra e mijra kombinime të ndryshme, të cilat do jepen gjatë shpjegimit të shumë emnave në këte libër.

Duke pas parasysh këto lloj formash dhe bashkimet e kuptimeve të tyne në krijimin e emnave dhe fjalëve të ndryshme nëpër botë, do jetë ma e kollajshme me u kriju një gjuhë ndërkombëtare e mbarë botnore e kuptueshme kollaj nga të gjithë, sepse nuk do jetë nevoja të mësohen mbi 20 mijë fjalë që ka çdo gjuhë, por vetëm disa qindra fjalë e shprehje një rrokshe, që të bashkueme, na krijojnë domethanie e fjali të shkurtna të tjera.

Veç re se shqiptarët nëpër botë e kanë shumë të lehtë mësimin e gjuhëve të ndryshme, sepse pa vetëdije truni i tyne kombinon këto shprehje një rrokshe në kombinimet e fjalëve të atyne gjuhëve, që ata duen të mësojnë.

Në shpjegimin e disa emnave e fjaleve duhet të merret parasysh edhe mënyra e shkrimit etrusk të emnave dhe fjalëve, ke të cilët mendohet se mungonte bashkëtingellorja “d” që zëvendësohej me “t”, si dhe “dh” me “th”, kështuqë fjalët një rrokshe: Dha=Tha; Di=ti etj, psh: Deti=Teti.

Të gjitha germat e alfabetit dhe të gjitha fjalët me një rrokje, që ndodhen në secilën gjuhë e që krijojnë me mijra fjalë të tjera shumë rrokshe, mendoj të quhen: bazamenti i çdo gjuhe, nga të cilat janë formu fjalët e tjera me shumë rrokje.

Jap mendimin tem, që të quhen me fjalën e shumë përhapun nëpër botë: ”AL, ALA”, që ka pikërisht kuptimin e krahut fluturues, engjyllit fluturak, ashtu si asht fjala, që asht fluturake, por ka edhe efekte hyjnore.

Studiuesit mund të shofin se sa “ala” ka në secilën gjuhë dhe se kush gjuhë asht ma e aftë tu japë kuptim fjalëve nëpër botë. Me anën e gjuhës shqipe, shof se emnat dhe shumë emërtime e fjalë nëpër botë kthehen në fjali të vogla dëftuese e jo si fjalë emërtuese, siç i përdorin shumë popuj.

Në këte libër te dyte do vazhdoj të shpjegoj kuptimin me anën e gjuhës shqipe të emnave, që deri më sot janë quejtë me origjinë arape, turke e të

shteteve të tjera. Në përgjithësi drejtuesit e feve të ndryshme kërkojnë të bindin botën se emnat kanë origjinë nga shejtorët e tyre pa ia dijtë domethanien.

Ngul kambë, që janë të vendalijve shqipfolës (albanofon, arianofon= alban-folës, arian-folës, latineve etj), që kanë jetu në ato troje në lashtësi qysh nga krijimi i njerëzimit. Me kalimin e shekujve, përdorimi i gjuhëve fetare ka bërë që të zhdurkin gjuhën e Yllorëve arianë, atë që flasim ne sot dhe emnat të mendohen si emna shejtorësh ke banuesit e atyne trojeve shqipfolëse të gjithnjë ndodhur në vendet e tyre para se të lindnin këto fë që janë sot.

Në Italinë e Veriut, (Bolzano, Beluno, Udine etj), popullsia ka pas e ka probleme me kishën katolike në vendosjen e emnave të fëmijëve të tyre. Nëse kisha i quante emna “paganë”, që nuk ishin në fjalorin e emnave katolikë, nuk pranonin tua regjistrin ata emna, kështu që popullsia atje detyrohej e detyrohet ti mbajë fëmijët me dy emna: Me atë që e regjistronte kisha, dhe me emnin “pagano-ilir”, që e kishin trashëgu brez mas brezi në familje. Po ashtu veprojnë edhe kisha ortodokse dhe fetë e tjera. Kjo dukuri ndodhi edhe ke ne për disa kohë në drejtim të kundërt, kur shteti komunist vendosi të heqë emnat fetarë e ti zavendësojë ato me emnat me origjinë ilire. Disa nga populli vendoste dy emna: Atë të regjistrimit dhe atë të feve që u takonin.

Për t’i vendos një emën fëmijës së sapolindun, në lashtësi merrej edhe mendimi i njerëzve të shejtë: druidëve, eremitëve, dervishëve, e ma vonë u përvetësuen e u ndanë prej priftave, hoxhallarëve e të tjerë drejtues shpirtnorë të popujve, që dolën ma vonë e që i shoshitën emnat në bazë të shejtorëve që u përkisnin feve të tyre. I ndanë emnat e i veshën me petkun fetar, gja që nuk asht e vërtetë.

Përderisa shof në “Pllakat e Zmeraldit të Thot Atlantideut”, fjalë mbi 12 mijë vjeçare sikur të ishin fjalë, që flasim sot në Shqipni e në vendet e tjera ku ka shqipfolës, kur shof emna të vjetër të përdorun në libra shumë të vjetër në gjithë botën, që duken si fjalë të përdoruna sot, duke ndigju nga miq të mij, që edhe në popujt e vjetër te Irlandës, të Baskëve, të Kaukazit, të Azisë, të Polinezisë e të vendalijve (indigjenëve) të Amerikës e në shumë vende të tjera të botës, që kanë fjalë të njejta me ato që ne flasim sot dhe arrijnë t’i kuptojnë e të hyjnë në biseda menjihërë, duke përdor këto fjalë të shejta shqipe, që edhe në formulat e në faljet e budistave gjinden e përdoren me shumicë, më shtohet siguria, që t’i shpjegoj plotësisht me anën e gjuhës shqipe.

Disa thonë se emnat kanë kuptime të ndryshme në vende e popuj të tjerë. U them atyne, se gjersa populli ynë i përdor këta emna, ka pa që kishin kuptime të bukura në gjuhën shqipe.

Ka edhe shumë emna të huej që janë vendos pa ia dijtë kuptimin, por besoj se me kalimin e kohës, duke u njoft edhe me përmbajtjen e emnave, njerëzit

do i vendosin emnat e fëmijeve të tyre, me kuptim e domethanës. Po e përsëris se:

-Para gati 100 vjetësh, “Ataturku”- Mustafa Qemali vendosi që: çdo fjalë e dialekt që përdoret në Turqi, edhe pse janë me origjinë pellazgo-shqiptare, persiane, arape apo mongole, do të quhen fjalë turke. Dhe ashtu u ba. Të gjithë studiuesit e botës i përmbahen atij vendimi. Ne që i kemi fjalët tona, nuk kemi pse i quejmë turke, sepse në fund të fundit edhe popullsia e Azisë së Vogël deri në shekullin XV ka pas fol gjuhën tonë.

Çfarë humbën shetet e Ballkanit gjatë ciptimit, dhe çfarë do fitonin nëse do pranonin gjuhën iliro-shqipe si gjuhën e tyre dhe jo gjuhët artificiale dhe fetare që kanë sot?

Nëse do ruhej gjuha e lashtë pellazgo-iliro-shqipe si gjuhë e përbashkët dhe jo këto gjuhë artificiale që kanë shtetet e Ballkanit të krijueme në trugun pellazgo-ilirik, popujt e Ballkanit do e ndjenin veten të një gjaku dhe do ndalonin lufnat përçamëse, që sollën gati çfarosjen dhe zhdukjen e tyre. Dallimeve fetare të bame nga fetë do u binte vlera dhe ky vend do ishte parajsë për të gjithë banorët e saj, e jo me luftna e përçamje që po nxiten nga fetë e ndryshme.

Në fillim të punës me këte libër, gjatë analizës së domethanies së emnave, u shtoja edhe domethanien në arab-isht, turq-isht, pers-isht etj, por duke pa që këto domethanie nuk përputheshin me fjalorin e gjuhëve të atyne shteteve, hoqa dorë nga domethaniet në gjuhët përkatëse dhe lashë vetëm domethaniet në shqip, që m'u dukën ma të bukura e ma të përshtatëshme. **Në popuj të tjerë, fjalët dhe emnat janë trashëgu vetëm si emërtime, pa ia dijtë përmbajtjen, ndërsa shqipja ia jep kuptimin si një fjali të bukur, të shkurtën e të saktë.**

Ma vonë i kanë vesh me kuptimin e detyrës së shejtorëve që i kanë pas ata emna.

Në këte libër të dytë me shpjegim emnash, po ndjek idenë teme të shpjegimit të emnave dhe fjalëve simas elementave bazë të gjuhës shqipe, që e shpjegova pak ma sipër, ku çdo germë, rrokje-fjalë ka një kuptim të caktuem e bashkimi i tyre më krijonë një fjali apo një frazë të caktueme me kuptim të bukur e të saktë në shqip. **Kur njerëzit të kërkojnë të dijnë domethanien dhe origjinën e emnave të tyre, nuk do kenë nevojë të kërkojnë në fjalorë të huaj, ku shumë mirë e shumë bukur marrin kuptim me anën e gjuhës shqipe.**

-----0-----

Në italisht: Parlare=P(i)arlare, që e shpjegoj me shqipen e sotme=Pi-ar-la-ar-è=pin ar, len ar, ku kuptoj se në lashtësi i vinin shumë randësi fjalës, sepse ajo pinte, thitthe vlera të arta, por edhe jepte, lente, lindte fjalë ari. Në shqip: Fjalos =Fialos=Fi-al-os=Fije lidhëse dhe engjyll fluturake osht, ose=Fije lidhëse engjyllore osht dhe më del kuptimi i shejtë i fjalës, që i ka shërby e i shërben njerzimit për tu lidh e bashkëvepru bashkarisht. E fos= thosh=dhosh, ku: Fos=f-os=fluturake osht dhe: tho-os=t'os=Të osht=të ekziston, sepse fjala e nxjerrë fluturim, e lindun, bahet e qenë, të osht, ekziston e ruhet në kujtesën njerëzore dhe kthehet në veprim e në vepër të dukshme e të qenë.

Shumë emërtime letrare, shkencore, historike etj të ashtuquejtun “grek, latin etj” u janë dhanë një domethanie arbitrare, kur shqipja ia jep të zberthym kuptimin e plotë të tyre.

Anti=Me kuptimin: E kundërta, përballë siç qëndron edhe Hana përballë tokës. An-t'i=Nga ana e Hanës të isht, ose: Si Hana të isht. Materia—anti materia=Përballë materies, siç rrin Hana me tokën

Terror=ther-or;

Teoria=the-ori-a=Thanie ari asht;

Theorema=The-or-emi-a=thënie-ori-emi (imja) asht.

Akropol=asht kro-kryet e pollit=Asht krye e pjellës.

Nekropol=Na esht kro, kryet e pollit, kryet e pjellës.

Vagina=Vagjina=Vau i gjinës=Vend kalimi i gjinisë etj, etj.

Duke pas parasysh këto pak shembuj e të tjerë në këte libër, kam kënaqësinë të them, **që të gjithë emnat, me kuptime shumë të bukura në gjuhën shqipe, do ti quej emna SHQIPTAR.**

Kush din shqip dhe asht i aftë ta flasë këte gjuhë yllore, duhet të ndjehet krenar për origjinën e tij, identitetin e tij, për gjuhën që flet, të cilën e kan pas fol: ZOTI i Gjithësisë, Zoti i Dodnës, Zoti i Atlantidës, Zotat e Olimpiti (Olimbit), edhe pejgamerët e shejtorët e të gjitha kohnave.

-----0-----

Para gati 2500 vjetësh, Herodoti i Halikarnasit, kur flet për pellazgët dhe Dodonën pellazgjike, sqaron se emnat e perëndive dhe të njerëzve ke pellazget, (besoj që ene emërtimi i vendeve S.H), shprehnin cilësinë e tyre, kështuqë kjo thanie asht një shtysë e fortë që më jep të drejtën ti shpjegoj emnat simas mënyrës teme të zberthimit, që i kam ba në këto 2 librat e mij. (Shif librin: “Studime shqiptare” me autor: Dr. Jur. Johan Georg Von Hahn, faqe 336-337).

Zoti Zecharia Sitchin (Zekaria Sitkin) në librin e tij “PLANETI i 12” qysh në fillim të faqes 22 na sqaron se emnat e njerëzve dhe të vendeve në lashtësi në Babiloni, Asiri, Akadi etj, para ma shume se 6 mijë

vjetësh, për të cilët ai ka ba atë studimin, simas atij dhe shumë studiuesve të tjerë, që ai i përmend aty, kishin kuptime të caktueme. Qysh në 1853 sir Henry Rawlinson (po aty), para Shoqatës Mbretnore Aziatike tërhoqi vemendjen se emnat e atillë nuk ishin as semite e as indo-europiane, as greke, (por PELLAZGE, shënimi im S. Hushi). Po në atë libër, në faqet 154-159, zoti Zakaria Sitkin na sqaron se nga studimet e studiuesve të ndryshëm, që ai i përmend aty, bota në lashtësi ishte nji gjuhëshe, por ishin vendime të marra nga “zota e pejgamerë” yllore të këqij, që nuk e shifnin me sy të mirë zhvillimin e njerëzve nëpër botë dhe që i detyronin ata të ndryshonin gjuhën dhe besimin fetar, kështuqë ata “pejgamerë” e kishin ma të lehtë ti përçanin e ta dobësonin gjëndjen dhe mas përmbysjes së madhe u vërejt se popujt kishin fillu të ndryshonin gjuhët e besimet fetare, (ku siç dihet, janë këto fë e ndasi fetare të ndryshueme, që kanë kriju luftnat edhe mrenda të njejtit popull, por me besime të ndryshme fetare. Njikohjesisht po mundohen të mçefin e të ndryshojnë historinë dhe lidhjen atlanideo-ariano-pellazgo-ilire-albano-shqipe.

Në atë libër unë shof fjalë shqipe siç i kam përmend ma sipër si psh: An,en, in, un, yn; ar, er, ir, ur, yr; at, et, ot, ut; al, ol, ul; ba, be, bi, bo; el, il, ul, yl; la, le, li, lo, lu; ra, re, ri etj etj me të cilat autori më kot mundohet të gjejë shpjegime me anën e gjuhës ebraike, që ai mundohet ti shpjegojë me shumë argumente, ma shumë vetëm me interpretime, që gati gjithnji nuk më duken bindës, kur unë aty shof se gjuha shqipe e sotme “i bie në kokë” me shpjegime të sakta.

Po ashtu edhe gjatë punimit me librat e z. Mauro Biglino, me të cilët po punoj mdërkohësisht.

Me anën e zbërthimit të emnave në këte libër u kujtoj dhe u mësoj njerëzve nëpër botë origjinën e tyre të lashtë hanore, yllore e hyjnore, e cila me dashje apo pa dashje ju asht fshi nga kujtesa.

Ftoj studiuesit e vendeve të tjera, të provojnë dhe ata në shpjegimin e emnave dhe fjalëve me gjuhët e tyre në këte mënyrë, që po baj unë dhe do të shofim se kush asht ajo gjuhë, që shpjegon ma bukur e me ma shumë kuptim fjalët dhe emnat nëpër botë.

NËSE PRITET E SHPRESOHET, SE DO TË KETË RIKTHIM PROFETI,
AI DO TË FLASË SHQIP.

AUTORI

Shumë emna i kam shpjegu me anën e gegnishtes, por në shumë të tjerë kam lanë domethaniet në dialektin me të cilin janë kriju, kështuqë lexuesit të njëfen edhe me dialektet e tjerë, të cilët bajnë pjesë në gjuhën tonë të pasun. Gjithashtu atje ku mbiemnat janë para emnave dhe foljeve, shpesh i kam lanë po ashtu që mos prish radhitjen e formimit të emnave e që më tregon që edhe populli ynë në të kaluemen ka pas përdor atë mënyrë radhitjeje e cila ruhet në gjuhë të ndryshme.

Edhe foljen “esht” në shumë raste kam parapëlqy ta lej siç asht e jo ta zavendësoj me foljen tonë “është”, sepse në shumë shkrime të vjetra e në shumë emna njerëzish e vendesh të lashtësisë e shof të shkruajtun pikërisht: “est, esht” dhe jo “është”. Po ashtu kam vepru edhe për shumë folje të tjera dialektale (aç, eç, iç, iq, uç, yç etj).

Emnat dhe matertialet për këte libër i kam marrë nga interneti, nga numeratorët telefonikë, nga jeta e përditshme, nga listat zgjedhore, nga personazhe librash të ndryshëm, që kam lexu dhe për emnat e vjetër, futem ke wikipedia, në internet për të marrë ndonji sqarim.

Shof që në shumicën e rasteve, në fjalorët e emnave në gjuhë të ndryshme, shpjegimet e emnave, nuk përputhen me fjalorin e shpjegimit të fjalëve të gjuhëve përkatëse, gja që më shton sigurinë se emnat janë me origjinë atlantideo-ariano-albane-shqipe gati në të gjithë botën.....

Gati të gjithë emnat janë me kuptim për të dyja gjinitë, pamvarësisht nga zanorja e fundit, edhe pse në shumë raste më “ka rrëshqit dora” dhe i kam interpretu në gjininë mashkullore.....

Zbërthimin e kuptimit të emnave të maposhtem po e baj në bazë të kuptimit me gjuhën shqipe të sotme. Studiuesit e vendeve të tjera, le të provojnë me anën e gjuhëve të tyne të sotme, ose me gjuhë të tjera “të vjetra, ose të vdekuna” e të vlersohet ma e mira.

Abanã. Abeona. A,b-an-à. I-e ditun-a, si Hana àsht. A-ba-an-à=Asht ba, Hana àsht.

Abant-e-i-o. A,b-an-t'è=Me dituni, si Hana të èsht, ose: A-ba-an-t'è=Asht ba, si Hana të èsht.

Abarbar-a-e. A,b-ar-ba-ra=Me dituni, si ar ba, ra (nga qielli), ose: A-ba-ar-bar-à=Asht ba si ar, bar (ilaç) àsht.

Abaré. Ab-ar-è=I-e ditun-a, ar èsht. A-ba-ar-è=Asht ba ar èsht. A-ba-re=Asht ba si reja, (reja ishte simbol madhështie).

Abas. Abes. Abis. A,b-as=I-e ditun-a me abetare të mësueme asht.

Abay. Abhay. A,b à y= I-e ditun-a asht ylli-a, ose: A-ba-y=Asht ba yll-a.

Abayomi. A-bà-y-om-i=Asht ba, ylli-a dhonë isht, ose:Asht ba, ylli em isht.

Abaz-e-o. Abezi. Shif: **Aba. Abas.** Mund të kuptohet edhe si: Abaz-a-e-i-o. Abez-a-e-i-o. A,b-à za; A,b-e-zi=Ditunia asht zanë (za=zi=nzanë, nzënë=gatu=mësu).

Abbai. Abbey. Abbaye. Abbie. Abbye. A,b-ba-y-è=I-e ditun-a, ba si ylli-a èsht.

Abdala. Abdaal. A,b-da-al-à=I-e ditun-a, dhanë, si engjyll-a àsht. (Da=dha).

Abdão. Ab-da-o=I-e ditun-a dhanë àsht.

Abdel-a. Abdil. Abdul. Abdyl-e.A,b-de-el-è=I-e ditun dhanë si ylli-a àsht.

Abdella. Abdulla. Abdylla. Abdullah. A,b-de-el (yl)-la=I-e ditun-a dhanë, si ylli-a u la në jetë.

Abdelcàder. Abdulcàder. Abdylcàder. A,b-de-el-ça-de-er=Me dituni dhanë el-a (yll-a), çàsht dhanë si era.

Abdelcarim. Abdelkarim. Abdylkarim. Abdelqarim. A,b-de-el-ç'ar-im=Me dituni dhanë si ylli-a, ç'àsht ari im (çfarë ari im, qy ari im, kah àsht ari im).

Abdes-a. A, b-de-es-à=Me dituni, me a,b, dhanë shejtënia asht, (es=shejtënia). (Shqipe e pastër).

Abdilaqim. A,b-di-il-aq-im=A,b (abetare) din, ylli-a asht imi (imja).

Abdurrahman. Abdurraman. A,b-du-ur-ra-am-an=Me dituni dhanë, urë shpirtnore, ra si Hana.

Abedaban. Abedabun. A,be-da-ba-an=Me dituni dhanë, ba si Hana

Abedi. Abedin. Abdi. Abdia. Abdias. Abidin. Abdiè. Të gjithë këto emna i kuptoj me shprehjen: A,be din=A,bi din. Dituni din=Abetaren din.

Abeer. A,b-è-er=I-e ditun-a esht si er-a, ose: Asht be er=Asht ba erë=Asht bej-a erës. Kështu merr kuptim edhe fjala “haber”, e keqkuptueme si e huaj. Haberret, aberet = lajmet përhapen si era.

Abeci. A,be-ç'i=Me dituni ç'isht.

Abel-a-e-i. A,be-el-à=Me dituni, ylli-a àsht, ose: A-be-el-à=Asht bej-a si ylli-a àsht.

Abelard-a-o. A,b-el-ar-da=Me dituni, yllë si ar dha (Zoti).

Abelina. A,be-el-in-a=Me dituni ylli-a ynë (in-a) asht.

Abelk-a-e. A,b-el-k'a=Me dituni ylli-a kah është.

Abella. A,b-el-la= Me dituni ylli-a u la (në jetë).

Abeltje. (Abeltie). A,b- el-t'je=Me dituni ylli-a të është.

Abequ-a-e. Në gjuhë të ndryshme, emna e fjalë, që kanë mbaresat “qua, que”, i quej të njiillojta me mbaresat-folje të shqipës: Që asht, që është. Njikohësisht “qu, squ” në ship i thuhet kur zgjohesh nga gjumi ose njeriut me mend. Emnin e kuptoj si: A-be-qu-à(è)=Asht bej-a, i-e qutë është.

Abetz-a-e-i-o. A,b-et-za (za, ze, zi, zo)=Me dituni e pleqsi zanë, (nza=nxa).

Abe-u-y. A,be-è-y=Me dituni bej-a esht si ylli-a.

Abeytu. A,be-y-t'u=Me dituni ylli-a të usht.

Abez-a-e-i-o. A,be-za-à=Me dituni nzanë është.

Abgar. A,b-gi-ar=Me dituni gjini prej ari.

Abharraç. Abharrach. A,b-ar-ra-aç=Me dituni e si ar ra (nga qielli) aç, (asht).

Abij. A-bij=asht mbi, ka lind.

Abhijat. A-bij-at=Asht biri (bija) me pleqsi.

Abhijay. Abij=A-bij=Asht biri (bija) ynë.

Abhijit-a-e. A,bi-ji-t'è=Me dituni hy-a të është.

Abhik. A,b-ik=A,b-hik=Me dituni e shtegtar-e. (Ik=shtegtar-e, që ka shetit botën).

Abhilash. A,b-il-ash=Me dituni ili-a asht, (ylli-a asht).

Abhina. A,b-hi-n'à =Me dituni hyjni-a na është.

Abhinandan. A,b-hi-n'an-dan= Me dituni hyjni-a nga Hana dhanë. (N'an=na-ana=nga Hana).

Abhisar. A,b-is-ar=Me dituni isht si ar.

Abhishek. A,b-ish-ek=I-e ditun-a isht shtegtar-e.

Abhlach. Ablač=A,b-la-aç=Me dituni lanë në jetë. (Aç=is=jeta=Zoti).

Abiding. A,bi-din-gi=Dituni din gjini (ynë). A,b-di-in-gi=Dituni din njishi gjinit (tonë).

Abidos. A,bi-do-os=Me dituni dhonë osht, ose: Asht biri (bija) ynë, me dituni është.

Abigail-a-e. Abigayl-a-e=A,bi-g(i)-à-il, yll-à. Me ditun-a gjini yllor asht, ose: Asht biri (bija), si ylli-a asht.

Abilan-a-e-i-o. Abilene. A,b-il-anà=I-e ditun-a yll e Hane asht.

Abilio. A,b-il-li-ò=Me dituni ylli-a lind osht, ose: Asht bir (bijë) si ylli-a lind është.

Abiran. A-bir-an=Asht dir (bijë) Hane.

Ablaa. A,b-la-à=Dijetar-e lanë (në jetë) asht.

Abler-i. A,b-le-er-ì=Me dituni leu, si era isht, ose: A-b(i)-le-er=Asht biri (bija), le si era isht.

Abner. A,b-n'er= Dijetar-e me nerje, me nder. A,b-n'er=I-e ditun-a na esht si era.

Abraã. A,b-ra-à=Me dituni ramë (nga qielli, nga yjet) është.

Abraham-o. Avraham. Abram-o. Avram. A,b-ram-o, shif: **Abraa.** A,b-ra-am-o=Me dituni ra, i-e dhanë (për tu ba me famë) osht. (“v” e lexoj “b”). A-ba-ra-am= Asht ba, i-e gatuem-e, i-e brumos (me mirësi), ramë (nga yjet), dhanë (nga Zoti) osht. A-vram-o=Asht i-e vramë, (sepse simas Biblës desh të vrasë të birin).

Absalom. A,b-(i)s-al-om=Me dituni isht, engjyll-a dhanë, (am=om=me dhanë).

Absalon. Absalan. A,b-(i)s-al-an(on)=Me dituni isht, si engjyll-a e si Hana.

Absbert-a-o. A,b-(i)s-be-er-t’=Me dituni isht, ba si era të asht, (të osht).

Abukcheech. A,b-uk-ke-eç=Me dituni e me forcë ujku që eç (që është, kah është).

Abul. Abyl. A,b-ul=Ab-yl=Me dituni yllore.

Aby. Shif: **Aba,** A,b-ysht(asht), ose: A,b-y=Me dituni yjnore.

Aca. Ace. Aci. Acc-a-o. Në gjuhë të ndryshme, germa “C” lexohet herë s’r’ç” e here s’r’k ose q”. Unë do marr atë, që më krijon kuptim ma të bukur në shqip. Aç-a=Ekzistenca asht, jeta asht, ku aç=asht=isht=jeta=ekzistenca.

Ak-à=I-e drejtë asht, ose: A-ka=Asht me forcë kau.

Acaci-a-o-us. Aç açi à=Jeta e jetës asht, ose: Aç-à-çi-à=Jetë asht, dritë syu asht.

Acely-a. A-çel-y-a= A çel ya=Asht çel yja, hyjnia.

Achaios=Açaios=A-ça-i(y)-os=Asht me bukuri, si ylli-a është.

Achaikos. Aç-à-ik-os= Jeta asht, shtegtar-e osht.

Achak. Açak=Aç-ak=Asht i-e drejtë, (ak, hak=drejtësi, i-e drejtë). Shif edhe: **Aki. Haki.**

Achal-a. Achall-a. Aç-al=Asht engjyll-a. Aç-al-la=Jetën engjyllore la (në jetë).

Achalraj. Ashalrai. Aç-al-ra-i(y)=Asht engjyll-a që ra (nga qielli).

Achill. Achillios. Acili-o. Akili. Aqili. Aç-ill=Aq-il=Asht ylli-a. (Akil, Aqil=A ki ylli=A-qi-il, ku: qi=qy=ki=ky). Ach-il-li-os=Aç il-a lindun. Mbaresat “è, es, ò, os” besoj që janë të ma vonëshme dhe bahen= Akill-esht. Achilli-osht. (Akilli-os).

Achillina. Akillina. Aç-ill-in-à=Asht ylli-a, yni-a asht. A-ki-il-lin-à=Asht ky yll, lind asht.

Achim. Akim. Aç- im=Asht imi (imja)=Jeta ime, (ku: aç=isht=jeta=ekzistenca). A ki im=Asht ki, ky imi (fëmija im, që do bahet i-e ndiguem-e). Akim=Ak-im=Haku im=Rrisku im, fati im.

Achintya. Akintya. A-ki-in-t’=Asht ky, yni-a të asht. Ose: Ak-in-ty(të)-à=Haku ynë të asht.

Açif. Aqif. Aç (aq)-i(y)-f=Asht ylli-a fluturak-e.

Açintya=Aç-in-ty-à=Jeta jonë të asht.

Achior. A-çi(sy)-or=Asht me bukuri, (ka sy) si ari. Aç-i-or=Asht ylli-a prej ari.

Achmed-a. Aç-me-da=Jetë më dha. **Akmeda**=Ak-me-da=Hakun më dha (Zoti).

Achod-a. Aç-o-da=Jeta asht nda, asht dhanë. Ak-o-da=Haku osht dhanë.

Achsa. Aç-sa=Aç-sy=Asht me bukuri, ka sy. (Sa, saj=se=sej=sy).

Achyuta. Aç-y-ut-à=Asht hy-a, yti (ztja) asht. Ak-y-ut à= Hak hy yti asht, (ut=yt-e=at=Me pleqsi).

Aci. Aki. Haki. Shif: **Aca**, por kuptohet edhe si: A-çi=Asht dritë syu, ka sy, ka paraqitje. Ak-i =Hak isht=I-e drejtë isht= Rrisku isht.

Açif. Akif. Aqif. Aç(aq)-i-f=Asht ylli-a fluturak-e. A-çi-f=Asht me bukuri engjyllore. Ak-i-f=I-e drejtë ylli-a fluturak-e.

Acira. Aç-ira= Asht hirësia, ose:=Jetë me hirësi është.

Acisl-a-e-o. Aç-is-le=Asht jeta, ekzistenca që ka le.

Acobharan Acobaran. Acobhràn. Aç-o-ba-ar-an=Jeta osht ba si ar e si Hana.

Ada. Ada-e-o. Aad-a-e-o. Adam. Adem. Adom. Adham. Eda. Ida. Oda.

A-da=Asht dhanë, (nga Zoti). Eda=Esht dhanë. Ida=Isht da, isht dhanë.

Adahy. Aday. A-da-y (hy)=Asht dhanë ylli-a=Asht dhanë hyja.

Adail. A-da-il=Asht dhanë ylli-a. Shif edhe: **Adil-e.**

Adain-a. A-da-in-à=Asht dhanë, yni-a asht, ose: Asht dhanë, njishi asht, ose: A-da-i-n'à=Asht dhanë, yll-a na është. Shif edhe: **Adin-a.**

Adal. A-da-al=Asht dhanë engjyll-a me krahë, (al=krah fluturues=engjyll).

Adalan-a. Adalon-a. Adalen-a. Adelan-a. Adolon-a. Adulona. A-dal-Ana=Asht dalë Hana (Ana, Ena, Ona, Una, Yna), ose=A-da-al-an-à=Asht dhanë engjyll-a Hanës.

Adalat. Adalet. A-da-al-at=Asht dhanë engjyll-a me pleqsi.

Adalbert-a-o. A-da-al,-be-er-t'à=Asht dhanë, si engjyll-a bej-a erës të asht.

Adalbrecht-(a). A-da-al-b(i)-reç-t'à=Asht dhanë engjyll-a, bir (bijë) resh të është.

Adalfried-a-i-o. A-da-al-f-ri-e-da=Asht dhanë engjyll-a, fluturak-e rinues-e dhane. **Adalfriedi.** A-da-al-f-ri-e-di=Asht dhanë engjyll-a fluturak-e, rinues-e me dituni.

Adalgis-a-o. A-da-al-gi-is-à=Asht dhanë engjyll-a, gjindje me shejtëni asht.

Adalgund-a-e. A-da-al-gi-un-da-à=Asht dhanë engjyll-a, gjindje Hane dhanë është.

Adalhard-a. A-da-al,-ar-da-a=Asht dhanë engjyll-a, si ar dhanë është.

Adalhelm-a. A-da-al,-el-m'à=Asht dhanë, engjylla si ylli-a më është.

Adáli-a-e. A-da-al-i(y)-à=Asht dhanë engjyll-a si ylli-a është.

Adalin-a. Adlind-a. Adalint-a. A-da-lin-t'à=Asht dhanë, lind të është. Shif:

Adali-a-e.

Adalmar-a. A-da-al-ma-ar-à=Asht dhanë engjyll-a, që mban ar është.

Adalric-o. Adalrich. A-da-al-ri-iç= Asht dhanë engjyll-a, rinues-e isht.

Adalton. A-da-al-t'on. Asht dhanë engjyll-a, të osht si Hona.

Adalvin. Adalwin. Nëse=Adal(b)in kemi=A-dal-bi-im=Asht dalë në jetë biri (bija) im-e.

Adam-o-u. Adem. Adom. Adham. Adhamh. Adhanh. Idem. Iden. Shif: **Ada.**

Adamant-i. A-da-am-an-t'f=Asht dhanë me dashuni, si Hana të ishte.

Adamina. A-dam-i-n'à=Asht dhanë, si ylli-a na është.

Adamir. A-da-m'ir=Asht dhanë, me isht me hirësi.

Adamudi. Adhamudhi. A-dham-u-di=Asht dhamë njëshi (u, uno) me dituni.

Adan-a. Adna. Ad(a)na. Aden-a. Adon-a-e-i. A-da-an-à= Asht dhanë, Hana është, ose shif: **Ada, Adam.** A-da-am=Asht dhanë me dashuni, ose: Asht dhanë.

Adanan. Adanon. Adnan. Shif: **Adan-a.**

Adanat-a. Adanet-a. Adonat. Odenato. A-dan-at=Asht dhanë me pleqsi.

Adanes-a. Adanis-a. A-dan-es(is)-a. Asht dhanë, me shejtëni është (as=is=i-e shejte=jeta).

Adanin-a. Adonin-a. A-da-An in-à=Asht dhanë, Hana ynë është.

Adanir-a. Shif: **Adamir,** ose: A-da-an-ir=Asht dhanë Hana me hirësi.

Adanit-a. A-da-an-i-t'à=Asht dhanë, si Han-a dhe ylli-a të është.

Adanol-a. (Mund të jetë edhe: **Adanal**). A-dan-ol (al)-à=Asht dhanë, si engjyll-a është.

Adanon-a. A-dan-on-à=Asht dhanë, si Hona asht.

Adanor-a. Adanar. Adenor. Adonor. A-dan-ar(or)=Asht dhanë prej ari.

Adão. Adae. Shif: **Ada.**

